imagjinare, mëkati i parë dhe larja e mëkatit do të mund ta shuajnë shumë më mirë urinë e popullit sesa fjalimet e gjata të deputetëve liberalë! Më tutje thuhet:

> «Në lutjen «Ati ynë» ne i lutemi zotit: «Mos na shtjerë në ngasje». Dhe në qoftë se ne e kërkojmë këtë për veten tonë, po kështu duhet të veprojmë edhe vetë kundrejt të afërmve tanë. Por kushtet tona shoqërore, natyrisht, janë burim gjithfarë ngasjesh për njerëzit, ndërsa skamja e tepruar i shtyn të bëjnë krime».

Dhe ne, zotërinjtë burokratë, gjyqtarë dhe këshilltarë koncistorialë të shtetit prusian, duke u nisur nga këto arsyetime, i torturojmë, u presim kryet, i burgosim e i rrahim si na do qejfi, që «t'i shtiem» proletarët «në ngasje», që edhe ata pastaj të na torturojnë, të na presin kryet, të na burgosin e të na rrahin. Dhe kjo patjetër ka për t'u bërë.

> «Një gjendje të tillë», — deklaron zoti këshilltar koncistorial, — «një shtet i krishterë *nuk mund* ta durojë; ai duhet të vijë në ndihmë».

Po, me llomotitjet e çmendura mbi përgjegjësinë solidare të shoqërisë, me tepricat imagjinare dhe me kambialet false të lëshuara në emrin e zotit-atë, të zotit-bir e K^0.

> «Bile mund edhe të ndërpriteshin» — mendon vëzhguesi ynë, këshilltari koncistorial, — «bisedimet për komunizmin, që edhe kështu janë të mërzitshme. Komunistët do të kishin heshtur shumë shpejt, sikur parimet sociale të krishterimit të zhvilloheshin nga njerëz që kishin për mision ta bënin këtë».

Parimet sociale të krishterimit kanë pasur 1 800 vjet kohë për t'u zhvilluar dhe nuk kanë aspak nevojë

të zhvillohen më tej nga këshilltarët koncistorialë prusianë.

Parimet sociale të krishterimit përligjnin skllavërinë antike, mburrnin bujkrobërinë mesjetare dhe dinë gjithashtu, sa herë që është nevoja, të mbrojnë, ndonëse me ngërdheshje të vajtueshme, shtypjen e proletariatit.

Parimet sociale të krishterimit predikojnë domosdoshmërinë e ekzistencës së klasave — të një klase sunduese dhe të një klase të shtypur, dhe për këtë të fundit nuk kanë veçse dëshirën e mirë që e para të jetë mirëbërësja e saj.

Parimet sociale të krishterimit e lënë për në qiell shpërblimin e premtuar nga këshilltari koncistorial për të gjitha poshtërsitë e pësuara, duke përligjur në këtë mënyrë ekzistencën e këtyre poshtërsive mbi tokë edhe në të ardhmen.

Parimet sociale të krishterimit i shpallin të gjitha poshtërsitë, që shtypësit u bëjnë të shtypurve, ose si një ndëshkim të merituar për mëkatin e parë e për mëkatet e tjera, ose si një provë që zoti me urtësinë e tij të pafund u bën njerëzve që të lajnë mëkatet e tyre.

Parimet sociale të krishterimit mburrin frikën, përbuzjen e vetvetes, vetëposhtërimin, përunjësinë, nënshtrimin, me një fjalë, të gjitha cilësitë e harbutëve, por për proletariatin, i cili nuk do që ta trajtojnë si harbut, për proletariatin guximi, vetëdija e dinjitetit personal, ndjenja e krenarisë dhe e pavarësisë janë shumë më të rëndësishme se buka e gojës.

Parimet sociale të krishterimit mbajnë damkën e dinakërisë dhe të hipokrizisë, kurse proletariati është revolucionar.

Ja si qëndron puna me parimet sociale të krishterimit.

Më poshtë:

> «Ne kemi pranuar se reformat sociale janë misioni më kryesor i monarkisë».

Vërtet? Deri tani as që është bërë fjalë për këtë. Por ta zëmë se është kështu. Cilat janë atëherë reformat sociale që paska për mision të zbatojë monarkia? Vënia e tatimit mbi të ardhurat, të cilin e kanë kopjuar nga organet liberale dhe i cili u dashka të japë teprica, për të cilat ministri i Financave nuk di gjë; bankat agrare fatkeqe, hekurudha e Prusisë Lindore dhe sidomos fitimet nga kapitali shumë i madh i përbërë prej mëkatit të parë dhe larjes së mëkatit!

«Kjo diktohet nga interesat e vetë pushtetit mbretëror» — sa poshtë ka rënë pushteti mbretëror!

«Këtë e kërkon gjendja e mjeruar e shoqërisë» — gjendje që tani kërkon më tepër taksa doganore mbrojtëse sesa dogma.

«Këtë porosit ungjilli» — këtë e porosit kush të duash, vetëm se jo zbrazësia e tmerrshme e arkës prusiane, e asaj humnere, në të cilën brenda tre vjetësh u zhdukën pa lënë gjurmë pesëmbëdhjetë milionët rusë. Po të flasim në përgjithësi, ungjilli porosit shumë gjëra dhe përveç të tjerave edhe tredhjen si fillim të reformës sociale të zbatuar për vetveten (Mateu, XXV).

> «Pushteti mbretëror», — thotë këshilltari ynë koncistorial, — «është një me popullin».

Këto fjalë janë vetëm një variant i frazës së vjetër: *«l'état c'est moi»** dhe i përgjigjen pothuajse fjalë për fjalë shprehjes që përdori Luigji XVI më 23 qershor 1789 kundër rendeve të veta rebele: po të mos bindeni, do t'ju dërgoj në shtëpi, *«et seul je ferai le bonheur de mon peuple»***.

Pushteti mbretëror duhet të gjendet tepër ngushtë

* — «shteti jam unë» (fjalët që thonë se i ka thënë Luigji XIV). *Red.*

** — «dhe do të kujdesem vetë për mirëqenien e popullit tim». *Red.*

kur vendos të përdorë një shprehje të tillë, dhe këshilltari ynë i shumëditur koncistorial duhet ta dijë se si ia shpërbleu atëherë populli francez Luigjit XVI fjalët që pat thënë.

> «Froni», — na siguron më poshtë zoti këshilltar koncistorial, — «duhet të mbështetet mbi një bazë popullore të gjerë; atëherë ai është më i sigurt se kurrë».

Po, derisa populli me një lëvizje të fuqishme të shpatullave të tij të gjera ta hedhë në hendek këtë superstrukturë të rëndë.

> *«Aristokracia»*, — përfundon zoti këshilltar koncistorial, — «ruan madhështinë e monarkisë dhe i jep asaj një shkëlqim poetik, por ia heq pushtetin real. *Borgjezia* i rrëmben asaj si pushtetin, ashtu edhe madhështinë dhe i lë vetëm një listë civile. Kurse *populli* ruan edhe pushtetin e monarkisë, edhe madhështinë e saj, edhe poezinë e saj».

Zoti këshilltar koncistorial, siç del nga kjo pjesë, për fat të keq, i ka marrë tepër seriozisht fjalët plot lëvdata që Frederik Vilhelmi i drejtoi *popullit të tij* në fjalimin e kurorës. Përmbysje e aristokracisë, përmbysje e borgjezisë dhe vendosje e një monarkie që të mbështetet në popullin — ja fjala e tij e fundit.

Sikur këto kërkesa të mos ishin vetëm fantazi, në to do të përmblidhej një revolucion i tërë.

Nuk do të ndalemi asnjë çast për të provuar se aristokracia nuk mund të përmbyset ndryshe veçse me përpjekje të përbashkëta të borgjezisë dhe të popullit dhe se sundimi i popullit në një vend, ku krahas me borgjezinë ekziston ende edhe aristokracia, është një marrëzi e vërtetë. Për të kundërshtuar përrallat e këtij lloji të një këshilltari koncistorial të Ejhornit, nuk ia vlen të sillen argumente serioze.

Ne dëshirojmë t'u bëjmë vetëm disa vërejtje dashamirëse atyre zotërinjve që mendojnë se monarkia prusiane, e cila është në pikë të hallit, mund të shpëtohet me një *salto mortale* drejt popullit.

Nga gjithë elementët politikë populli është më i rrezikshmi për mbretin. Jo ai popull, për të cilin flet Frederik Vilhelmi dhe i cili për shkelmat dhe për lëmoshat qesharake që i japin falenderon me sy të përlotur, — ky popull pa dyshim nuk është i rrezikshëm, sepse ai nuk ekziston veçse në mendjen e mbretit. Kurse populli i vërtetë, proletarët, fshatarët e vegjël dhe të vobektët e qytetit — siç shprehet Hobsi, është *puer robustus, sed malitiosus*, një djalë plot shëndet, por i prapë, që nuk lejon ta tërheqin për hunde as mbretërit e dobët as mbretërit e majmë.

Ky popull para së gjithash do t'i shkëpusë madhërisë së tij një kushtetutë me të drejtën e përgjithshme të votës, lirinë e organizimit, lirinë e shtypit dhe gjëra të tjera të papëlqyeshme.

Dhe kur t'i ketë arritur të gjitha këto, ai do t'i shfrytëzojë ato për ta shprehur sa më parë qëndrimin e tij edhe ndaj *pushtetit* edhe ndaj *madhështisë* edhe *ndaj poezisë* së monarkisë!

Ai që mban sot me dinjitet titullin mbretëror do të duhet ta quajë veten të lumtur, në qoftë se populli do t'i japë atëherë detyrën e deklamuesit publik në shoqërinë zejtare të Berlinit me një listë civile prej 250 talerësh dhe një gotë birrë në ditë.

Në qoftë se zotërinjtë këshilltarë koncistorialë, të cilët tani kanë në dorë fatet e monarkisë prusiane dhe të gazetës «Rheinischer Beobachter», dyshojnë për këtë, atëherë le t'i hedhin ndonjëherë një sy historisë. Kjo s'është asgjë përpara horoskopëve që u ka përgatitur historia mbretërve që i kanë bërë thirrje popullit të tyre.

Edhe Karli I i Anglisë i bëri thirrje *popullit të vet* duke u ankuar kundër rendeve të veta. Ai i bëri thirrje

popullit të vet duke e ftuar të rrokte armët kundër parlamentit. Por populli e shpalli veten kundërshtar të mbretit, flaku jashtë nga parlamenti deputetët që nuk përfaqësonin interesat e popullit dhe, në fund të fundit, e detyroi parlamentin, i cili në këtë mënyrë u bë përfaqësi e vërtetë e popullit, t'ia priste kokën mbretit. Kështu përfundoi thirrja që i bëri Karli I popullit të vet. Kjo ndodhi më 30 janar 1649; më 1849 do të jetë dyqindvjetori i kësaj ngjarjeje.

Edhe Luigji XVI i Francës i bëri thirrje *popullit të vet*. Tre vjet me radhë ai i bëri thirrje një pjese të popullit kundër pjesës tjetër dhe kërkonte popullin *e vet*, popullin e vërtetë, popullin që t'i qëndronte besnik dhe të cilin ai nuk mundi ta gjente asgjëkundi. Ai e gjeti atë, më në fund, në kampin e Koblencit, në radhët e ushtrive prusiane dhe austriake. Por popullit të tij në Francë kjo iu duk e tepruar. Më 10 gusht 1792 populli e mbylli atë në Templ* dhe thirri Konventën Kombëtare, e cila përfaqësonte popullin nga çdo pikëpamje.

Kjo Konventë e shpalli veten kompetente të shqyrtonte *thirrjen* e ish-mbretit dhe, pasi e diskutoi atë, e dërgoi mbretin në Sheshin e Revolucionit, ku u ekzekutua në gjotinë më 21 janar 1793.

Ja ç'ndodh kur mbretërit *u bëjnë thirrje popujve të tyre*. Dhe se ku të shpie dëshira e këshilltarëve koncistorialë për të themeluar monarki demokratike, këtë do ta shohim pak më vonë.

---

* — burg në kohën e revolucionit francez (1789-1794). *Red. Përkth.*

K. MARKS e F. ENGELS

MANIFESTI I PARTISË KOMUNISTE

[*Nga kapitulli i dytë dhe i tretë*]

...Akuzat që i bëhen komunizmit, duke u nisur nga pikëpamje fetare, filozofike dhe në përgjithësi nga pikëpamje ideologjike, nuk meritojnë të shqyrtohen imtësisht.

A duhet, vallë, ndonjë zgjuarsi e veçantë për të kuptuar se së bashku me kushtet e jetesës së njerëzve, me marrëdhëniet e tyre shoqërore, me qenien e tyre shoqërore, ndryshojnë edhe parafytyrimet, pikëpamjet dhe nocionet, — me një fjalë, ndërgjegjja e tyre?

Po ç'na provon historia e ideve përveç asaj që prodhimi shpirtëror pëson ndryshime së bashku me prodhimin material? Idetë sunduese të çdo kohe kanë qenë gjithnjë vetëm idetë e klasës sunduese.

Flasin për ide që revolucionojnë gjithë shoqërinë. Me këtë shprehin vetëm faktin se brenda shoqërisë së vjetër janë formuar elementet e shoqërisë së re, se krahas me dekompozimin e kushteve të vjetra të jetesës dekompozohen edhe idetë e vjetra.

Kur bota e vjetër po perëndonte, fetë e vjetra u mundën nga feja kristiane. Kur idetë kristiane në shekullin XVIII u përmbysën nga idetë iluministe, shoqëria feudale hyri në një luftë për vdekje kundër borgjezisë, e cila në atë kohë ishte revolucionare. Idetë e lirisë së ndërgjegjes dhe të fesë nuk shprehin gjë tjetër në fushën e dijes veçse sundimin e konkurrencës së lirë.

«Por», mund të na thonë, «idetë fetare, morale, filozofike, politike, juridike etj., sigurisht, kanë ndryshuar gjatë zhvillimit historik. Kurse feja, morali, filozofia, politika dhe e drejta janë ruajtur gjithnjë gjatë këtyre ndryshimeve të pareshtura.

Ka pastaj disa të vërteta të përjetshme, si liria, drejtësia etj., që janë të përbashkëta për të gjitha fazat e zhvillimit shoqëror. Mirëpo komunizmi i zhduk të vërtetat e përjetshme, ai zhduk fenë, moralin, në vend që t'i përtërijë ato; pra, ai është në kundërshtim me gjithë zhvillimin historik të mëparshëm».

Ç'është kjo akuzë? Historia e të gjitha shoqërive që kanë ekzistuar deri më sot është zhvilluar duke kaluar përmes antagonizmave të klasave, antagonizma që në epokat e ndryshme kanë marrë forma të ndryshme.

Por çfarëdo formash që të kenë marrë këta antagonizma, shfrytëzimi i një pjese të shoqërisë nga një tjetër është një fakt i përbashkët për të gjithë shekujt e kaluar. Prandaj s'është për t'u çuditur, në qoftë se ndërgjegjja shoqërore e të gjithë shekujve, me gjithë këto lloje të shumta dhe këto ndryshime, zhvillohet në disa forma të përbashkëta, në format e ndërgjegjes, të cilat do të zhduken plotësisht vetëm kur të zhduket përgjithmonë antagonizmi i klasave.

Revolucion komunist do të thotë të përmbysen në mënyrën më të vendosur marrëdhëniet e pronësisë, të trashëguara nga e kaluara: s'është për t'u çuditur, në qoftë se gjatë zhvillimit të tij ai shkëputet në mënyrën më të vendosur nga idetë e së kaluarës.

* * *

Ashtu sikurse prifti ecte kurdoherë krah për krah me feudalin, socializmi klerikal ecën krah për krah me socializmin feudal[41].

S'ka gjë më të lehtë se t'i japësh një ngjyrë socia-

liste asketizmit kristian. A nuk ka luftuar edhe kristianizmi kundër pronës private, kundër martesës, kundër shtetit? Dhe në vend të këtyre, a nuk ka predikuar ai se duhet të jesh mirëbërës dhe lypës, se duhet të mos martohesh dhe të mortnosh trupin, se duhet të bësh jetën e murgjve dhe të shkosh në kishë? Socializmi kristian[42] s'është gjë tjetër veçse uji i bekuar, me të cilin prifti spërkat mërinë e aristokratëve...

K. MARKS e F. ENGELS

RECENSION I LIBRIT

*TË G. Fr. DAUMERIT «FEJA E SHEKULLIT TË RI. PËRPJEKJE PËR NJË ARGUMENTIM AFORISTIK TË KOMBINUAR», pj. 1-2, HAMBURG, 1850**

«Një zotni nga *Nurembergu*, që në përgjithësi kishte mendime të lira dhe që nuk ishte aspak i shurdhër ndaj së resë, i urrente tmerrsisht intrigat e demokratëve. Ai simpatizonte Rongen dhe kishte varur portretin e tij në dhomën e vet. Po kur mori vesh se Rongeja ishte me demokratët, ai e mori fotografinë e tij dhe e vari në nevojtore. Ai tha njëherë: o, sikur të jetonim nën pushtetin e kamxhikut rus, sa të lumtur do ta ndieja veten! Ai vdiq në një kohë trazire dhe unë besoj se, megjithëqë ishte plak, atë e çuan në varr vetëm brengat dhe hidhërimet që i shkaktuan ngjarjet» (vëll. II, f. 321-322).

Sikur ky filistin i vajtueshëm nga Nurembergu, në vend që të vdiste, të ishte marrë me mbledhjen e fragmenteve dhe të sentencave, të nxjerra nga «Korrespondent von und für Deutschland», nga Shileri e Gëteja, nga tekstet shkollore të vjetra dhe nga librat e rinj të bibliotekave të leximit, ai do të kishte shpëtuar veten nga vdekja dhe zotin Daumer nga barra e rëndë e har-

* G. Fr. Daumer. «Die Religion des neuen Weltalters. Versuch einer combinatorisch-aphoristischen Grundlegung». 2B-de, Hamburg, 1850. *Red.*

timit të dy vëllimeve të «argumentimit aforistik të kombinuar». Ç'është e vërteta, në këtë rrethanë ne nuk do të kishim pasur rastin mësimdhënës që të njiheshim me fenë e shekullit të ri dhe njëkohësisht me martirin e saj të parë.

Vepra e z. Daumer ndahet në dy pjesë: njëra «paraprake» dhe tjetra «themelore». Në pjesën paraprake ky Ekart[43] besnik i filozofisë gjermane shpreh dëshpërimin e thellë që këta dy vjetët e fundit edhe gjermanët me kulturë e që dinë të mendojnë kanë lajthitur nga udha e vërtetë dhe kanë hequr dorë nga fitoret e paçmueshme të mendimit për hir të veprimtarisë revolucionare thjesht «të jashtme». Çastin e tanishëm ai e quan të përshtatshëm për t'iu drejtuar përsëri ndjenjave më të mira të kombit; ai tregon se ku të çon mohimi kaq mendjelehtë i gjithë kulturës gjermane, që është e vetmja gjë që e bën qytetarin gjerman të jetë diçka. Ai riprodhon gjithë brendinë e kulturës gjermane me anë të aforizmave më energjikë që mund të gjenden në thesarthin e erudicionit të tij, duke e kompromet uar kështu kulturën gjermane jo më pak se filozofinë gjermane. Antologjia e tij e produkteve më të larta të frymës gjermane me banalitetin dhe me trivialitetin e vet ua kalon edhe librave të leximit më të rëndomtë, të shkruar për zonjushat e shtresave të kulturuara. Duke filluar nga sulmet filistine të Gëtes dhe të Shilerit kundër revolucionit të parë francez, nga fraza klasike: «është e rrezikshme të zgjosh luanin»[44], deri te letërsia më e re, kryeprifti i fesë së re tregon një zell të veçantë për të gjetur çdo pjesë ku shfaqet ngurtësia gjermane që ankohet si nëpër gjumë për lëvizjen historike që ajo urren. Autoritete të kalibrit të Fridrih Raumerit, Bertold Auerbahut, Lohnerit, Moric Karierit, Alfred Majsnerit, Krugut, Dingelshtedtit, Ronges, «Nürnberger Bote», Maks Valdaut, Shternbergut, German Mojrerit, Luiza Astonit, Ekermanit, Noakut, «Blätter für literarische Unterhaltung», A. Kunces,

Gilanit, T. Mundtit, Safirit, Guckovit, të një zonje «nga dera Gaterer» etj. — ja shtyllat, mbi të cilat ngrihet tempulli i fesë së re. Lëvizja revolucionare, kundër së cilës ngrihet këtu kjo anatemë prej kaq zërash, kufizohet për z. Daumer, nga njëra anë, me politikanizmin më banal prej kafeneje, që lulëzon në Nuremberg nën patronazhin e «Korrespondent von und für Deutschland», dhe, nga ana tjetër, me teprimet e harbutëve, për të cilat z. Daumer ka idenë më fantastike. Burimet, nga të cilat ai merr këtu njoftimet e tij, janë plotësisht të denja për autoritetet e përmendura më sipër: krahas me «Korrespondent»-in e Nurembergut, që është përmendur më se një herë, figurojnë «Bamberger Zeitung», «Landbötin» e Mynhenit, «Allgemeine Zeitung» e Augsburgut etj. Pikërisht ai banalitet prej filistini, që sheh gjithnjë te proletari vetëm rreckamanin e pagdhendur dhe të demoralizuar e që fërkon duart me kënaqësi kur sheh kasaphanën e qershorit të vitit 1848 në Paris, ku u vranë më tepër se tre mijë nga këta «rreckamanë», — ky banalitet prej filistini revoltohet kur sheh ndonjë njeri që tallet me shoqëritë sentimentale për mbrojtjen e kafshëve.

> «Mundimet e tmerrshme» — thërret z. Daumer në f. 293 të vëllimit të parë, — «që heqin kafshët fatkeqe në duart e pamëshirshme, tiranike të njeriut, për këta barbarë qenkan «gjë pa rëndësi», për të cilën s'e vlen të shqetësohesh!»

Gjithë luftën klasore të sotme z. Daumer e shikon vetëm si një luftë të «brutalitetit» kundër «qytetërimit». Në vend që ta shpjegojë atë me kushtet historike të jetës së këtyre klasave, ai i gjen shkaqet e saj në intrigat demagogjike të disa njerëzve me synime të këqija që luajtkan me instinktet e ulëta të harbutëve, duke e ndërsyer atë kundër shtresave të kulturuara.

«Ky reformizëm demokratik... ngjall zilinë, zemërimin, lakminë e klasave të ulëta të shoqërisë kundër klasave të larta; një mjet i mrekullueshëm për ta bërë njeriun më fisnik dhe më të mirë dhe për të hedhur themelet e një shkalle më të lartë kulture!» (vëll. I, f. 289).

Z. Daumer as që e di se ç'luftë u është dashur të bëjnë «klasave të ulëta të shoqërisë kundër klasave të larta» për të krijuar qoftë edhe vetëm «një shkallë kulture» si ajo e Nurembergut dhe për të bërë të mundur daljen e një luftëtari të tillë kundër Mollohut *à la* Daumer[45].

Pjesa e dytë, pjesa «themelore», përmban vetëm një paraqitje pozitive të fesë së re. Këtu shfrehet tërë zemërimi i këtij filozofi gjerman për faktin që lufta e tij kundër krishterimit është harruar, për faktin që populli mban një qëndrim indiferent ndaj fesë — të vetmit objekt që meriton vëmendjen e filozofit. Për të vënë në vend nderin e dikurshëm të zanatit të tij, të mënjanuar nga konkurrenca, të urtit tonë, pas sharjeve të vazhdueshme kundër fesë së vjetër, nuk i mbetet asgjë tjetër veçse të përftojë një fe të re. Por kjo fe e re, në përputhje të plotë me ato që u thanë në pjesën e parë, nuk është veçse një mbledhje e mëtejshme sentencash, vargjesh nga albume dhe *versus memoriales** të kulturës filistine gjermane. Suret e kuranit të ri[46] nuk janë asgjë tjetër veçse një sërë frazash, me të cilat mbulohet nga pikëpamja morale dhe paraqitet në një dritë të bukur poetike rendi që ekziston në Gjermani. Megjithëqë këto fraza nuk kanë një formë fetare të drejtpërdrejtë, ato nuk e humbin aferinë e tyre të ngushtë me fenë e vjetër.

«Një rend i ri dhe marrëdhënie botërore krejt të reja mund të lindin vetëm në saje të feve të reja. Si

* — vargjesh përkujtimore. *Red.*

shembull dhe provë, që tregon se ç'është në gjendje të bëjë feja, mund të shërbejnë krishterimi dhe islamizmi. Dhe si një ilustrim mjaft i qartë dhe bindës, që tregon se sa e pafuqishme dhe e kotë është politika abstrakte dhe ekskluziviste, mund të shërbejnë lëvizjet që u zhvilluan në vitin 1848» (vëll. I, f. 313).

Në këtë tezë kuptimplote duket gjithë banaliteti dhe gjithë injoranca e këtij «mendimtari» gjerman, i cili i ngatërron «fitoret» e vogla gjermane, veçanërisht ato bavareze «të marsit», me lëvizjen evropiane të vjetëve 1848 dhe 1849 dhe i cili kërkon që shpërthimet e para ende tepër të dobëta të një revolucioni të madh që është duke u formuar dhe duke u koncentruar të sjellin menjëherë një «rend të ri dhe marrëdhënie botërore krejt të reja». E gjithë lufta sociale e ndërlikuar, betejat e para pararojë të së cilës këta dy vjetët e fundit u zhvilluan nga Parisi deri në Debrecin dhe nga Berlini deri në Palermo, përmblidhen, sipas të urtit z. Daumer, në faktin se në janar të vitit 1849 «shpresat e bashkimeve kushtetuese të Erlangenit u shtynë për një kohë shumë të pacaktuar» (vëll. I, f. 312) dhe në frikën se mos shpërthente një luftë e re, e cila do të mund ta shqetësonte në mënyrë të papëlqyeshme z. Daumer në punën e tij për studimin e Hafizit, të Muhametit dhe të Bertold Auerbahut.

Pikërisht kjo cektësi e turpshme e z. Daumer e bën atë që të mos e marrë parasysh fare faktin se krishterimi erdhi pas dështimit të plotë të «rendit botëror» antik, se krishterimi nuk ishte veçse një shprehje e thjeshtë e këtij dështimi, se «rendi botëror krejt i ri» nuk lindi nga brenda, në saje të krishterimit, por vetëm atëherë kur hunët dhe gjermanët «u vërsulën nga jashtë mbi kufomën e Perandorisë Romake»; se pas invadimit gjerman nuk ishte «rendi botëror i ri» që iu përshtat krishterimit, por, përkundrazi, ka qenë krishterimi që pësoi ndryshime krahas çdo faze të re të këtij

rendi botëror. Le të na sjellë z. Daumer qoftë edhe një shembull ndryshimi të rendit botëror të vjetër me daljen e një feje të re, gjatë së cilës të mos kenë ndodhur njëkohësisht konvulsione kolosale «të jashtme dhe politike abstrakte».

Është e qartë se pas çdo përmbysjeje historike të madhe të një rendi shoqëror bëhet përmbysje edhe në pikëpamjet dhe idetë e njerëzve, duke përfshirë edhe idetë e tyre fetare. Por përmbysja e tanishme ndryshon nga të gjitha përmbysjet e mëparshme pikërisht sepse njerëzit, më në fund, e gjetën të fshehtën e këtij procesi të përmbysjeve historike dhe prandaj ata, në vend që ta hyjnizonin përsëri këtë proces praktik, «të jashtëm», duke i dhënë formën e ekzaltuar të një feje të re, flakën çdo fe.

Pas predikimeve morale të druajtura të urtësisë së re universale, e cila ua kalon edhe predikimeve të Kniges[47], sepse ajo përmban gjithçka që është e domosdoshme jo vetëm për marrëdhëniet me njerëzit, por edhe për marrëdhëniet me kafshët, — pas sentencave morale të Solomonit vjen kënga e këngëve e Solomonit të ri.

> «*Natyra* dhe *gruaja* janë me të vërtetë hyjnore, ndryshe nga *njeriu* dhe *burri*... Flijimi i asaj që është njerëzore përpara asaj që është natyrore, i burrit përpara gruas, është e vetmja përunjësi dhe i vetmi vetëmohim i vërtetë, virtyti dhe përshpirtnia më e lartë, bile e vetmja» (vëll. II, f. 257).

Këtu shohim se si cektësia dhe padija e themeluesit tonë spekulues të fesë shndërrohen në frikë të hapët. Z. Daumer do që t'i ikë tragjedisë historike që i kanoset dhe kërkon shpëtim në të ashtuquajturën natyrë, d.m.th. në idilin e druajtur fshatar dhe predikon kultin e gruas për të mbuluar përunjësinë e vet prej femre.

Kulti i natyrës, që predikon z. Daumer, është mjaft

origjinal. Ai mundi të dilte me një pikëpamje reaksionare edhe në krahasim me krishterimin. Ai mundohet të rivendosë në një formë të modernizuar fenë e lashtë të natyrës, që ekzistonte para krishterimit. Në këtë drejtim, natyrisht, të gjitha sa thotë ai nuk janë gjë tjetër veçse llomotitje patriarkale të krishtera gjermane mbi natyrën, që shprehen, për shembull, në këto vargje:

> «Më mëso, o nën'-natyrë,
> Të kërkoj tënden fytyrë
> Dhe të ndjek ashtu si dhe ti
> Rrugën tënde me përunjësi!»

> «Këtyre gjërave u ka dalë moda, por kjo gjë nuk ka qenë në dobi të kulturës, të përparimit dhe të lumtërisë njerëzore» (vëll. II, f. 157).

Kulti i natyrës kufizohet, siç e shohim, me shëtitjet e së dielës të qytetarit provincial, i cili habitet si fëmijë që qyqja i lëshon vezët e veta në fole të huaja (vëll. II, f. 40), që lotët bëjnë të mos thahet sipërfaqja e syrit (vëll. II, f. 73) etj., dhe i cili më në fund u lexon me një drithmë fetare fëmijëve të vet oden e Klopshtokut, kushtuar pranverës (vëll. II, f. 23 dhe vij.). Natyrisht, as që bëhet fjalë për shkencat e sotme të natyrës, të cilat bashkë me industrinë moderne po revolucionojnë gjithë natyrën dhe po i japin fund, përveç naiviteteve fëmijnore të tjera, edhe qëndrimit fëmijnor të njerëzve ndaj natyrës. Por ne dëgjojmë, nga ana tjetër, aluzione misterioze dhe supozime filistine të pakuptueshme mbi profecitë e Nostradamusit, mbi të pamit e dyfishtë të skocezëve* dhe mbi magnetizmin e kafshëve.

---

* Të pamit e dyfishtë të skocezëve — aftësi që gjoja kishin sidomos banorët e pjesës së sipërme të Skocisë për të parashikuar të ardhmen dhe për të shpjeguar fenomenet e ndryshme. *Red. Përkth.*

Por ka ardhur koha që ekonomia fshatare e prapambetur e Bavarisë, ai truall ku mbijnë njëlloj edhe priftërinjtë edhe Daumerët, më në fund, të punohet me ndihmën e agrikulturës moderne dhe të makinave moderne.

Me kultin e gruas puna qëndron po ashtu si edhe me kultin e natyrës. Kuptohet vetiu se z. Daumer nuk thotë as gjysmë fjale për gjendjen sociale të sotme të gruas, se, përkundrazi, ai flet vetëm për gruan si të tillë. Ai mundohet t'i ngushëllojë gratë për mungesën e të drejtave të tyre civile, duke i bërë objekt të një kulti të veshur me fraza po aq të zbrazëta, sa edhe misterioze dhe plot pretendime. Kështu, në lidhje me faktin se krahas me martesën ato i humbin talentet e tyre, sepse u bie barra të kujdesen për fëmijët (vëll. II, f. 237), ai i ngushëllon duke u kujtuar se kanë aftësinë t'i ushqejnë fëmijët me gji edhe deri në moshën gjashtëdhjetë vjeç (vëll. II, f. 251) etj. Z. Daumer e quan këtë «flijim të burrit përpara gruas». Dhe për të gjetur në atdheun e tij figura ideale grash për teorinë e tij të flijimit të burrit, ai është i detyruar t'u drejtohet damave të ndryshme të aristokracisë së shekullit të kaluar. Në këtë mënyrë kulti i gruas përmblidhet përsëri në varësinë e vajtueshme të letrarëve nga mbrojtësët e tyre shumë të nderuara — shih Vilhelm Majsterin[48].

«Kultura», — për rënien e së cilës qahet z. Daumer në jeremiadat e tij, — është kultura e asaj kohe kur Nurembergu lulëzonte si një qytet perandorak i lirë, kur industria e Nurembergut, kjo përzierje origjinale arti dhe zejtarie, luante një rol të rëndësishëm, është kultura e borgjezisë së vogël gjermane që po vdes bashkë me këtë borgjezi të vogël. Në qoftë se zhdukja e klasave të mëparshme, për shembull e kalorësisë, mundi të jepte material për vepra madhështore të artit tragjik, borgjezia e vogël, natyrisht, nuk mund të japë asgjë tjetër përveç shfaqjeve të pafuqishme të një zemërimi fanatik dhe një koleksioni proverbash dhe këshillash si ato

të Sançó Pançës. Z. Daumer është një vazhdim i thjeshtë e i thatë, pa pikë humori i Hans Saksit. Filozofia gjermane, që kërcet gishtërinjtë nga dëshpërimi dhe që vajton para shtratit të vdekjes të atit të saj adoptiv — borgjezisë së vogël gjermane, — ja tabloja mallëngjyese që na paraqet feja e shekullit të ri.

F. ENGELS

LUFTA FSHATARE NË GJERMANI

[*Kapitulli II*]

Grupimi në bashkime më të mëdha i rendeve shoqërore aq të ndryshme në atë kohë ishte pothuajse i pamundshëm për shkak të decentralizimit, të autonomisë lokale e provinciale, të veçimit industrial e tregtar të provincave nga njëra-tjetra dhe për shkak të gjendjes së keqe të komunikacioneve. Ky grupim lind vetëm me përhapjen e përgjithshme të ideve revolucionare fetare e politike në periudhën e Reformës. Rendet e ndryshme të shoqërisë që i përqafojnë këto ide ose që ngrihen kundër tyre e përqëndrojnë, ç'është e vërteta, me shumë vështirësi dhe në mënyrë të përafërt kombin gjerman në tri kampe të mëdha: në kampin katolik ose reaksionar, në kampin luteran ose reformator të byrgerëve dhe në atë revolucionar. Nëse edhe kjo ndarje e madhe e kombit nuk qe fort konsekuente, nëse në dy kampet e para ne gjejmë pjesërisht po ata elementë, kjo shpjegohet me gjendjen e shthurjes, në të cilën ndodhej shumica e rendeve shoqërore zyrtare të trashëguara nga mesjeta, dhe me decentralizimin, si rezultat i të cilit po ato rende shoqërore në vende të ndryshme përkohësisht mund të bashkoheshin me rryma të kundërta. Vjetët e fundit kemi pasur aq shpesh mundësi të vëmë re në Gjermani gjëra të po këtij lloji, saqë nuk duhet të na habisë një pleksje në dukje kaq e larme e rendeve dhe e klasave në kushtet shumë më të ndërlikuara të shekullit XVI.

Ideologjia gjermane, me gjithë përvojën e kohëve të fundit, vazhdon të shohë në luftën që i dha fund mesjetës vetëm grindje teologjike të tërbuara. Historiografët tanë dhe burrat e ditur të shtetit tonë thonë se, sikur njerëzit e asaj kohe të kishin mundur të merreshin vesh midis tyre për gjërat qiellore, ata nuk do të kishin pasur asnjë arsye të ziheshin për punët e kësaj bote. Këta ideologë besojnë aq lehtë, saqë i marrin për të vërteta të gjitha iluzionet që krijon për veten e vet një epokë ose që krijojnë ideologët e kohës për epokën e vet. Njerëzit e këtij lloji shohin, për shembull, në revolucionin e vitit 1789 vetëm një mori debatesh tepër të zjarrta në lidhje me epërsinë e monarkisë kushtetuese mbi monarkinë absolute, në revolucionin e korrikut shohin një diskutim praktik rreth pathemeltësisë të së drejtës «për hir të zotit», në revolucionin e shkurtit — një orvatje për të zgjidhur çështjen: «monarki apo republikë»? etj. Për *luftën e klasave*, e cila zhvillohet në kohën e këtyre tronditjeve dhe shprehja e thjeshtë e së cilës janë parullat politike që shkruhen gjithnjë mbi flamujt, — për këtë luftë klasash ideologët tanë as tani nuk kanë idenë më të vogël, ndonëse për këtë flasin me zë mjaft të lartë jo vetëm lajmet që vijnë nga jashtë, por edhe mërmëritjet plot zemërim të shumë mijëra proletarëve gjermanë.

Edhe në kohët e të ashtuquajturave luftëra fetare të shekullit XVI fjala ishte para së gjithash për interesa klasore materiale shumë të përcaktuara; këto luftëra ishin po ashtu luftë klasash, sikurse edhe konfliktet e brendshme të mëvonshme në Angli dhe në Francë. Që kjo luftë klasash bëhej atëherë nën parulla fetare dhe që interesat, nevojat dhe kërkesat e klasave të ndryshme fshiheshin nën një mbulesë fetare, kjo nuk e ndryshon aspak thelbin e çështjes dhe shpjegohet lehtë me kushtet e kohës.

Mesjeta u zhvillua mbi një bazë krejt primitive. Ajo fshiu nga faqja e dheut qytetërimin, filozofinë, po-

litikën dhe jurisprudencën e lashtë, për të filluar nga e para në të gjitha fushat. E vetmja gjë që mori ajo nga bota e vjetër që vdiq ishte krishterimi dhe disa qytete gjysmë të shkatërruara, që e kishin humbur gjithë qytetërimin e tyre të mëparshëm. Si rezultat i kësaj, siç ndodh në të gjitha fazat e hershme të zhvillimit, monopoli i kulturës intelektuale ra në duart e priftërinjve dhe vetë kultura mori kështu një karakter kryesisht teologjik. Në duart e priftërinjve politika dhe jurisprudenca, si edhe të gjitha shkencat e tjera u bënë degë të thjeshta të teologjisë dhe për to u zbatuan po ato parime që sundonin në të. Dogmat e kishës u bënë në të njëjtën kohë edhe aksioma politike, ndërsa tekstet e biblës muarën në çdo gjyq fuqinë e ligjit. Edhe atëherë, kur u formua kasta e veçantë e juristëve, jurisprudenca mbeti edhe për shumë kohë nën kujdestarinë e teologjisë. Ky sundim i plotë i teologjisë në të gjitha fushat e veprimtarisë mendore ishte në të njëjtën kohë edhe pasojë e domosdoshme e pozitës që kishte kisha si sinteza më e përgjithshme dhe sanksionimi më i lartë i rendit feudal ekzistues.

Është e qartë se në këto kushte të gjitha sulmet e shprehura në formë të përgjithshme kundër feudalizmit dhe në radhë të parë sulmet kundër kishës, të gjitha doktrinat revolucionare sociale dhe politike duhej të ishin në të njëjtën kohë kryesisht edhe herezi teologjike. Që të mund të sulmoheshin marrëdhëniet shoqërore ekzistuese, duhej t'u hiqej aureola e shenjtërisë.

Opozita revolucionare kundër feudalizmit kalon përmes gjithë mesjetës. Ajo paraqitet, sipas kushteve të kohës, herë në formën e misticizmit, herë në formën e një herezie të hapët, herë në formën e një kryengritjeje të armatosur. Sa për misticizmin, dihet mirë se sa të varur prej tij ishin reformatorët e shekullit XVI; shumë gjëra mori prej tij edhe Mynceri. Herezitë ishin pjesërisht një reaksion i barinjve patriarkalë të Alpeve

kundër feudalizmit që po depërtonte ndër ta (valdensët[49]), pjesërisht një shprehje e opozitës kundër feudalizmit nga ana e qyteteve që i kishin kapërcyer caqet e tij (albigezët[50]), Arnoldi nga Breshja etj.); pjesërisht ato ishin kryengritje e hapët e fshatarëve (Xhon Bolli, predikuesi hungarez[51] në Pikardi etj.). Herezitë patriarkale të valdensëve, si edhe kryengritjen e zviceranëve ne mund t'i lëmë mënjanë këtu si një orvatje reaksionare, nga forma dhe nga përmbajtja, për t'u izoluar nga zhvillimi historik, orvatje që për më tepër kishte vetëm një rëndësi lokale. Në të dyja format e tjera të herezisë mesjetare gjejmë qysh në shekullin XII shfaqjet e para të antagonizmit të madh midis opozitës së byrgerëve dhe asaj të fshatarëve dhe plebejve, e cila bëri që të dështonte Lufta fshatare. Ky antagonizëm vazhdoi gjatë gjithë mesjetës së mëvonshme.

Herezia e qyteteve — që në të vërtetë është herezia zyrtare e mesjetës — drejtohej kryesisht kundër priftërinjve, duke sulmuar pasurinë dhe pozitën politike të tyre. Po ashtu siç kërkon sot borgjezia një *gouvernement à bon marché*, një qeveri që të kushtojë lirë, po kështu edhe byrgerët e mesjetës kërkonin para së gjithash një *église à bon marché*, një kishë që të kushtonte lirë. Reaksionare nga forma, si edhe çdo herezi, që në zhvillimin e mëtejshëm të kishës dhe të dogmave nuk shikon veçse një degjenerim, herezia e byrgerëve kërkonte të rivendosej organizimi i thjeshtë i kishës si në kohën e krishterimit të hershëm dhe të prishej kasta e mbyllur e priftërinjve. Ky organizim pak i kushtueshëm i kishës parashikonte heqjen e murgjve, të prelatëve, të kurisë romane, me një fjalë, të çdo gjëje që kushtonte shtrenjtë. Qytetet, që ishin vetë republika, ndonëse ndodheshin nën kujdestarinë e monarkëve, me sulmet e tyre kundër papatit shprehnin për herë të parë në një formë të përgjithshme idenë se forma normale e sundimit të borgjezisë është republika. Qëndrimi i tyre armiqësor ndaj një sërë dogmash dhe dispozitash

të kishës shpjegohet pjesërisht me sa u tha më sipër, pjesërisht me kushtet e tjera të jetës së tyre. Për shembull, nuk ka njeri që ta shpjegojë më mirë se Bokaçoja shkakun e sulmeve të tyre të tërbuara kundër beqarisë së klerit. Përfaqësuesit kryesorë të kësaj rryme ishin: Arnoldi nga Breshja në Itali dhe në Gjermani, albigezët në Francën Jugore, Xhon Uiklifi në Angli, Husi dhe kalikstinët[52] në Çeki. Fakti se opozita kundër rendit feudal shfaqet këtu vetëm si opozitë kundër feudalizmit *kishtar* shpjegohet mjaft thjesht kështu: qytetet kudo ishin bërë një rend i njohur dhe kishin mjaft mundësi për të luftuar kundër feudalizmit laik, duke u mbështetur në privilegjet e tyre, me armë ose në mbledhjet e rendeve.

Si në Francën Jugore, ashtu edhe në Angli e në Çeki shohim se pjesa më e madhe e fisnikërisë së ulët bashkohet me luftën e qyteteve kundër priftërinjve e me herezitë, fenomen ky që shpjegohet me varësinë e fisnikëve të vegjël nga qytetet, si edhe me interesat e përbashkëta të të dy palëve në luftën e tyre kundër princërve dhe prelatëve. Këtë fenomen do ta hasim përsëri në Luftën fshatare.

Një karakter krejt të ndryshëm kishte herezia, që ishte shprehja e drejtpërdrejtë e kërkesave të fshatarëve dhe të plebejve dhe që pothuajse kudo pleksej me kryengritjen. Ndonëse ajo kishte të gjitha kërkesat e herezisë byrgere në lidhje me priftërinjtë, me papatin dhe me rivendosjen e organizimit kishtar të kohës së krishterimit të hershëm, në të njëjtën kohë shkonte shumë më larg. Ajo kërkonte rivendosjen e barazisë së hershme të krishterë midis anëtarëve të komunitetit fetar si dhe njohjen e kësaj barazie si normë edhe në marrëdhëniet midis qytetarëve. Nga «barazia e bijve të zotit» ajo nxirrte barazinë civile dhe qysh atëherë pjesërisht edhe barazinë e pasurive. Barazimi i fisnikëve me fshatarët, i patricëve dhe i qytetarëve të privilegjuar me plebejtë, heqja e angarisë, e teloznave, e tatimeve,

e privilegjeve dhe zhdukja të paktën e dallimeve më të dukshme në pasuri — ja kërkesat që ngriheshin në mënyrë pak a shumë të prerë si përfundime që dilnin medoemos nga doktrina e krishterimit të hershëm. Kjo herezi e fshatarëve dhe e plebejve, e cila në periudhën e lulëzimit të feudalizmit, për shembull te albigezët, mezi që mund të dallohet nga herezia byrgere, zhvillohet e bëhet një pikëpamje partie e përcaktuar mirë në shekujt XIV dhe XV, kur ajo shfaqet zakonisht në mënyrë krejt të pavarur përkrah herezisë së byrgerëve. Kështu, për shembull, Xhon Bollin, predikues të kryengritjes së Uot Tajlerit[53] në Angli, e gjejmë përkrah pasuesve të Uiklifit, ndërsa taboritët në Çeki përkrah kalikstinëve. Qysh atëherë te taboritët nën cipën teokratike fillon të duket një prirje republikane, e cila në fund të shekullit XV dhe në fillim të shekullit XVI u zhvillua më tej nga përfaqësuesit e plebejve në Gjermani.

Në këtë kategori herezie hyn edhe ekzaltimi i sekteve mistike, i flagelantëve, i lolardëve[54] etj., që vazhdonin traditën revolucionare në periudha kur lëvizja qe shtypur.

Plebejtë në atë kohë ishin e vetmja klasë që ndodhej fare jashtë shoqërisë zyrtare. Ata qëndronin si jashtë kastës feudale, ashtu edhe jashtë asaj të byrgerëve. Ata nuk kishin as privilegje as pronë; ata nuk kishin as zotërime të ngarkuara me detyrime të rënda, siç kishin fshatarët dhe byrgerët e vegjël. Nga të gjitha pikëpamjet ata ishin skamës dhe nuk gëzonin asnjë të drejtë; kushtet e jetesës së tyre nuk kishin asnjë lidhje të drejtpërdrejtë me institucionet e atëhershme, të cilat nuk i përfillnin fare. Ata ishin simptoma e gjallë e shpërbërjes së shoqërisë feudale e asaj korporative-byrgere dhe në të njëjtën kohë lajmëtarët e parë të shoqërisë borgjeze moderne.

Kjo gjendje e plebejve shpjegon pse qysh në atë kohë pjesa plebejase e shoqërisë nuk mund të kufizohej

vetëm me luftën kundër feudalizmit dhe qytetarëve të privilegjuar; pse asaj, të paktën në ëndrrat e veta, i duhej të dilte edhe përtej caqeve të shoqërisë borgjeze moderne që po lindte; pse ajo, që nuk kishte asnjëfarë prone, duhej të vinte në dyshim institucionet, idetë dhe pikëpamjet që ishin karakteristike për të gjitha format shoqërore të mbështetura në kontradiktat klasore. Ëndrrat hiliastike[55] të krishterimit të hershëm ishin në këtë drejtim një pikënisje e përshtatshme. Por në të njëjtën kohë kjo dëshirë për të dalë jo vetëm përtej caqeve të së tashmes, por edhe të së ardhmes, nuk mund të ishte veçse një dëshirë fantastike, një dhunim i realitetit, dhe e para përpjekje për ta realizuar praktikisht atë duhej ta hidhte lëvizjen prapa, në ato caqe të ngushta që lejonin kushtet e atëhershme. Sulmet kundër pronës private dhe kërkesa që pasuria të bëhej e përbashkët duhej të degjeneronin patjetër në një organizim primitiv bamirësie; barazia e papërcaktuar e krishterë mund të përfundonte shumë-shumë në «barazinë» borgjeze «përpara ligjit»; heqja e çdo autoriteti u shndërrua në fund të fundit në krijimin e qeverive republikane të zgjedhura nga populli. Anticipimi i komunizmit në fantazi u bë në të vërtetë një anticipim i marrëdhënieve borgjeze moderne.

Këtë anticipim të historisë së mëvonshme, i cili bie krejt në kundërshtim me realitetin, por i cili shpjegohet fare mirë me kushtet e jetesës së plebejve, për herë të parë e hasim në *Gjermani*, te *Tomas Mynceri* dhe te partia e tij. Është e vërtetë se edhe taboritët kishin njëfarë bashkësie hiliastike të pasurisë, por vetëm si një masë thjesht ushtarake. Vetëm te Mynceri këto ide komuniste embrionale bëhen për herë të parë shprehje e aspiratave të një grupi shoqëror real, vetëm te ai ato formulohen në mënyrë deri diku të përcaktuar, dhe fill pas tij ato i hasim përsëri në çdo tronditje të madhe popullore, derisa ato dalngadalë shkrihen me lëvizjen proletare moderne, ashtu si në mesjetë, kur lufta e fshatarësisë së lirë kundër sundimit feudal, që po e shtinte gjithnjë më tepër në kthetrat e veta, shkrihet me luftën e bujkrobërve dhe të fshatarëve të varur për zhdukjen e plotë të shtypjes feudale.

Ndërsa në të parin nga tri kampet e mëdha, në atë të *katolikëve-konservator*, ishin grumbulluar të gjithë elementët që ishin të interesuar për ruajtjen e rendit ekzistues, d.m.th. pushteti perandorak, princërit e kishës dhe një pjesë e princërve laikë, shtresat më të pasura të fisnikërisë, prelatët dhe patriciati i qytetit, nën flamurin e reformës *luterane të moderuar të byrgerëve* u bashkuan elementët kamës të opozitës — masa e fisnikëve të ulët, byrgerët, bile edhe një pjesë e princërve laikë, që shpresonin të pasuroheshin me anë të konfiskimit të pasurive të kishës dhe që donin të shfrytëzonin rastin e volitshëm për të fituar më shumë pavarësi nga perandoria. Më në fund, fshatarët dhe plebejtë u bashkuan në një parti *revolucionare*, kërkesat dhe doktrinat e së cilës më qartë qenë formuluar nga Mynceri.

Luteri dhe Mynceri nga doktrinat e tyre, si dhe nga karakteri e veprimet e tyre janë secili përfaqësuesi i vërtetë i partisë së vet.

Gjatë periudhës prej vitit 1517 deri në vitin 1525 *Luteri* bëri po atë evolucion që bënë konstitucionalistët gjermanë modernë prej vitit 1846 deri në vitin 1849 dhe që bën çdo parti borgjeze, e cila është gjendur përkohësisht në krye të lëvizjes dhe së cilës ia kalon gjatë kësaj lëvizjeje partia plebejane ose proletare që ndodhet prapa saj.

Më 1517, kur Luteri u ngrit për herë të parë kundër dogmave dhe organizimit të kishës katolike, opozita e tij nuk kishte ende një karakter pak a shumë të përcaktuar. Pa shkuar përtej caqeve të kërkesave të herezisë së vjetër byrgere, ajo nuk përjashtonte asnjë tendencë më radikale, dhe as që mund ta bënte këtë. Në radhë të parë duhej të bashkoheshin gjithë elementët

opozitarë, duhej të vihej në veprim energjia revolucionare më e vendosur, duhej që tërë masa e herezive që kishin ekzistuar deri në atë kohë t'i kundërvihej ortodoksisë katolike. Po kështu borgjezët tanë liberalë qysh në vitin 1847 ishin revolucionarë, e quanin veten socialistë e komunistë dhe dilnin me idetë e emancipimit të klasës punëtore. Në këtë periudhë të parë të veprimtarisë së Luterit natyra e tij e fortë fshatare u shfaq në mënyrën më të vrullshme.

> «Në qoftë se tërbimi i tyre i furishëm» (d.m.th. i priftërinjve katolikë romakë) «do të vazhdojë, atëherë unë mendoj se do të jetë vështirë të gjendet ndonjë mjet tjetër i mirë për ta frenuar atë, përveç njëje: që mbretërit dhe princërit të përdorin forcën, të armatosen dhe t'u bien këtyre njerëzve të dëmshëm që helmojnë gjithë botën dhe t'i japin fund një herë e përgjithmonë, *me armë e jo me fjalë*, lojës së tyre. Në qoftë se kusarët ne i ndëshkojmë me shpatë, vrasësit me litar dhe heretikët me zjarr, a nuk duhet t'u biem sa më shpejt edhe këtyre mësuesve të dëmshëm të korruptimit, papëve, kardinalëve, ipeshkve dhe gjithë bandës tjetër të Sodomës katolike romake, t'u biem atyre *me çdo lloj arme që të kemi dhe t'i lajmë duart tona në gjakun e tyre?*»

Por ky zjarr i parë revolucionar nuk zgjati shumë. Rrufeja që lëshoi Luteri qëlloi në shenjë. I gjithë populli gjerman u vu në lëvizje. Nga njëra anë, fshatarët dhe plebejtë në thirrjet e tij kundër priftërinjve, në predikimin e tij të lirisë së krishterë panë sinjalin e kryengritjes; nga ana tjetër, me të u bashkuan byrgerët më të moderuar dhe një pjesë e mirë e fisnikërisë së ulët; rryma e përgjithshme tërhoqi me vete edhe princërit. Disa mendonin se kishte ardhur dita për t'i larë hesapet me gjithë shtypësit e vet, të tjerë donin vetëm të thyenin fuqinë e priftërinjve, t'i jepnin fund varësisë nga Roma, hierarkisë katolike dhe të pasuroheshin nga konfiskimi i pasurive të kishës. Partitë u ndanë dhe nxorën përfaqësuesit e vet. Luteri duhej të zgjidhte midis tyre. Ai, ndorje e kurfyrstit të Saksonisë, profesori i nderuar i Vitembergut, që brenda një nate u bë i fuqishëm dhe i famshëm, njeri i madh, i rrethuar nga një suitë e tërë ithtarësh dhe lajkatarësh, nuk u lëkund për asnjë çast. Ai hoqi dorë nga elementët popullorë të lëvizjes dhe u hodh në anën e byrgerëve, të fisnikëve e të princërve. Thirrjet e tij për një luftë shfarosëse kundër Romës pushuan; Luteri filloi të predikonte tani *zhvillimin paqësor* dhe *rezistencën pasive* (krahaso, për shembull, «Fisnikëve të kombit gjerman», viti 1520 etj.). Ftesës së Hytenit për të shkuar te ai dhe te Zikingeni në Ebernburg, qendër e komplotit të fisnikëve kundër priftërinjve dhe princërve, Luteri iu përgjigj:

> «Unë nuk do të doja që ungjilli *të mbrohet me dhunë e me gjakderdhje*. Qe Fjala ajo që mundi botën, në saje të Fjalës u ruajt kisha dhe po me anë të Fjalës ajo do të ringjallet, dhe antikrishti, siç e fitoi mbretërinë e vet pa dhunë, pa dhunë edhe do të bjerë».

Kjo kthesë ose, më mirë të themi, ky përcaktim më i saktë i orientimit të Luterit shënoi fillimin e atyre pazarllëqeve të gjata në lidhje me institucionet dhe me dogmat që duhej të ruheshin ose të reformoheshin, e atyre dredhive diplomatike, të neveritshme, lëshimeve, intrigave dhe ujdive, si rezultat i të cilave lindi Kredoja e Augsburgut[56], kjo kushtetutë e kishës së reformuar byrgere, e arritur pas shumë pazarllëqesh. Ky ishte njëlloj me matrapazllëkun që u përsërit në formë politike me një përpikni të neveritshme pak kohë më parë në asambletë kombëtare gjermane, në asambletë e pajtimit, në dhomat e rishikimit të kushtetutës dhe në

parlamentin e Erfurtit[57]. Në këto bisedime u pa fare qartë karakteri mikroborgjez i reformës zyrtare.

Në qoftë se Luteri, tani e tutje qe përfaqësues i reformës byrgere, predikoi përparimin brenda ligjit, ai kishte për këtë arsye të forta. Shumica e qyteteve kishte marrë anën e reformës së moderuar; fisnikëria e ulët po bashkohej gjithnjë e më tepër me të; një pjesë e princërve ishte për të, një pjesë tjetër lëkundej. Suksesi i saj mund të quhej i siguruar të paktën në një pjesë të madhe të Gjermanisë. Po të vazhdonin të zhvilloheshin ngjarjet në mënyrë paqësore edhe në të ardhmen, krahinat e tjera nuk do të mund t'i qëndronin për një kohë të gjatë presionit të opozitës së moderuar. Kurse çdo tronditje me dhunë duhej të çonte në një konflikt midis partisë së moderuar dhe partisë ekstremiste, — partisë së plebejve dhe të fshatarëve, duhej të largonte nga lëvizja princërit, fisnikët dhe shumë qytete; do të mbeteshin vetëm dy mundësi: ose fshatarët dhe plebejtë do të fitonin kundër partisë së byrgerëve, ose të gjitha partitë përparimtare do të thyheshin nga restaurimi katolik. Dhe kohët e fundit ne kemi pasur mjaft shembuj që tregojnë se si partitë borgjeze, me të korrur qoftë edhe fitoren më të vogël, mundohen të dredhojnë midis Skillës së revolucionit dhe Karibdës* së restaurimit nëpërmjet përparimit brenda ligjit.

Meqenëse për shkak të kushteve të përgjithshme shoqërore dhe politike të asaj kohe rezultatet e çdo ndryshimi duhej të ishin patjetër në dobi të princërve dhe të rrisnin pushtetin e tyre, edhe reforma byrgere, sa më tepër shkëputej nga elementët plebejas dhe

* Sipas mitologjisë greke Skilla dhe Karibda ishin dy përbindësha (dy shkëmbinj) që mbylleshin kur kalonin anijet midis tyre dhe i shtypnin. *Red. Përkth.*

fshatarë, aq më shumë duhej të binte vazhdimisht nën kontrollin e princërve që e kishin pranuar reformën. Vetë Luteri po bëhej gjithnjë më tepër shërbëtori i tyre, dhe populli e kuptonte fare mirë këtë gjë kur thoshte se Luteri është bërë, si edhe të tjerët, shërbëtor i princërve dhe kur në Orlamynd e përcolli Luterin me një breshër gurësh.

Kur shpërtheu Lufta fshatare, dhe për më tepër në vendet ku princërit dhe fisnikët ishin në pjesën më të madhe katolikë, Luteri u mundua të luante rolin e ndërmjetësit. Ai sulmoi me vendosmëri autoritetet. Vetë ato, thoshte ai, me masat e tyre shtypëse kishin shkaktuar kryengritjen; kundër tyre ishin ngritur jo fshatarët, por vetë perëndia. Por, në të vërtetë, thoshte ai, nga ana tjetër, edhe kryengritja është një gjë kundër perëndisë dhe kundër ungjillit. Në fund të fundit ai u bënte thirrje të dyja palëve që të bënin lëshime reciproke dhe u propozoi të merreshin vesh me të mirë midis tyre.

Mirëpo në kundërshtim me këto propozime dashamirëse ndërmjetësimi, kryengritja filloi të përhapej me të shpejtë, duke përfshirë edhe krahinat protestante që ishin nën sundimin e princërve, të fisnikëve dhe të qyteteve luterane dhe shumë shpejt i kaloi caqet e një reforme «të arsyeshme» byrgere. Fare pranë Luterit, në Turingi, e vendosi kuartierin e vet të përgjithshëm fraksioni më i vendosur i kryengritësve, i kryesuar nga Mynceri. Edhe pak suksese dhe tërë Gjermania do të ishte përfshirë nga flaka, Luteri do të ishte rrethuar dhe, ndoshta, do të ishte ndjekur me ushtë si tradhtar dhe e gjithë reforma byrgere do të ishte fshirë nga rryma e vrullshme e revolucionit të fshatarëve e të plebejve. Nuk kishte më kohë për t'u menduar. Përballë revolucionit u harruan të gjitha grindjet e vjetra; në krahasim me bandat e fshatarëve shërbëtorët e Sodomës katolike romake ishin shqerra të buta, bij të urtë të perëndisë; byrgerët dhe princërit, fisnikët dhe prif-

tërinjtë, Luteri dhe papa u bashkuan «kundër bandave gjakatare e kusare të fshatarëve»[58].

> «Kush të mundë, le *t'i vrasë, t'i mbysë* dhe *t'i therë, fshehurazi* dhe *sheshit,* siç vritet një *qen i tërbuar*», — thërret Luteri... — «Prandaj, zotërinj të dashur, ndihmonani, shpëtonani; në mundsh, vra, pre e shtyp dhe në vdeksh vetë, lum ti, sepse s'ka dhe s'mund të ketë vdekje më të lumnueshme. Asnjë mëshirë të rreme për fshatarët. Kush ka mëshirë për ata, për të cilët as vetë zotit jo vetëm që nuk i vjen keq, por dëshiron t'i ndëshkojë dhe t'i zhdukë, ai bashkohet vetë me rebelët. Më vonë edhe vetë fshatarët do të mësohen ta falenderojnë zotin që, pasi të kenë dhënë një lopë, mund të gëzojnë në qetësi tjetrën; ndërsa princërve kryengritja do t'u tregojë se ç'shpirt ka turma, e cila duhet të qeveriset vetëm me forcë. «I urti thotë: *cibus, onus et virga asino**; kurse fshatarët mjaft e kanë edhe bykun e tërshërës; ata nuk marrin vesh me fjalë dhe janë pa mend, ndaj le t'i mësojnë pushka dhe kamxhiku që të bëhen të bindur, sepse vetë e kanë kërkuar. Ne duhet të lutemi për ta që të përunjen; po s'u bë kjo, nuk duhet të ketë vend as për mëshirë. *Atëherë le t'ua thonë fjalën e tyre armët,* përndryshe ata kanë për të bërë një mijë herë më keq»».

Krejt po me këtë gjuhë flisnin edhe të lumët tanë borgjezë socialistë dhe filantropë kur proletariati pas ngjarjeve të marsit kërkoi pjesën e vet nga frytet e fitores.

Me përkthimin e biblës Luteri i dha lëvizjes së plebejve një armë të fuqishme. Me anë të biblës ai i kundërvuri krishterimit të feudalizuar të kohës së vet krishterimin modest të shekujve të parë, shoqërisë feudale që po shpërbëhej — tablonë e një shoqërie që nuk

* — gomarit jepi ushqim, barrë dhe thupër. *Red.*

e njihte fare hierarkinë e ndërlikuar dhe artificiale feudale. Fshatarët e përdorën në të gjitha drejtimet këtë armë kundër princërve, fisnikëve dhe priftërinjve. Tani Luteri e ktheu atë kundër fshatarëve dhe hartoi në bazë të biblës një ditiramb të vërtetë të pushtetit të vendosur nga zoti, një ditiramb që nuk kishte mundur ta bënte gjer atëherë asnjë sahanlëpirës i monarkisë absolute. Pushteti i princërve me hir të zotit, nënshtrimi i heshtur, bile edhe bujkrobëria u sanksionuan me ndihmën e biblës. Me këtë u hoq dorë jo vetëm nga kryengritja fshatare, por edhe nga rebelimi i vetë Luterit kundër pushtetit kishtar e laik; Luteri në këtë mënyrë tradhtoi për hatër të princërve jo vetëm lëvizjen popullore, por edhe atë byrgere.

A është nevoja të përmendim emrat e borgjezëve, të cilët pak kohë më parë na dhanë përsëri shembuj të një mohimi të tillë të së kaluarës së vet?

Le t'i kundërvëmë tani reformatorit byrger, Luterit, revolucionarin plebejas, *Myncerin.*

Tomas Mynceri lindi në *Shtolberg,* rrëzë Harcit, rreth vitit 1498. I ati, viktimë e arbitraritetit të kontit të Shtolbergut, thonë, mbaroi në litar. Që kur ishte pesëmbëdhjetë vjeç, Mynceri themeloi në Hale një shoqëri të fshehtë kundër arkipeshkvit të Magdeburgut dhe kishës katolike romane në përgjithësi. Dijet e tij të thella në teologjinë e atëhershme shpejt i siguruan atij gradën e doktorit dhe postin e kapelanit të manastirit të murgeshave në Hale. Që kur ishte këtu ai shfaq një përbuzje të thellë për dogmat dhe për ritet kishtare, gjatë meshës nuk i përmend fare fjalët mbi shndërrimin e bukës në trup dhe të verës në gjak të Krishtit dhe e ha, siç thotë për të Luteri, trupin e zotit të pakonsakruar. Objekti kryesor i studimeve të tij ishin shkrimet e mistikëve mesjetarë; sidomos shkrimet hiliastike të kalabrezit Joakim. Mbretëria mijëvjeçare, gjyqi i mbramë kundër kishës së degjeneruar dhe botës së shthurur, që kishte profetizuar dhe përshkruar ky shkri-

mtar, i dukeshin të afërta Myncerit me fillimin e Reformës dhe të trazirës së përgjithshme që karakterizonte atë kohë. Predikimet e tij në fshatrat e rretheve miratoheshin nga të gjithë. Më 1520 ai shkoi në Cvikau, si i pari predikues ungjillor. Këtu gjeti një nga sektet e ekzaltuara hiliastike, që vazhdonin të ekzistonin fshehurazi në shumë krahina; qetësimi dhe veçimi i tyre i përkohshëm shërbenin vetëm për të fshehur opozitën që po rritej vazhdimisht ndër shtresat e ulëta të shoqërisë kundër rendit ekzistues, dhe kur turbullimi i përgjithshëm u rrit ata filluan të dilnin më haptazi dhe më me vendosmëri. Ky ishte sekti i anabaptistëve, në krye të të cilit ishte Niklas *Shtorhu*. Ata predikonin afrimin e ditës së gjyqit të mbramë dhe të mbretërisë mijëvjeçare; ata kishin «vegime, ekstaza dhe shpirtin e profecisë». Shpejt ata ranë në konflikt me këshillin e Cvikaut. Mynceri mori anën e tyre, ndonëse ai kurrë nuk u bashkua plotësisht me ta, bile bëri që ata t'i nënshtroheshin ndikimit të tij. Këshilli u ngrit në mënyrë të vendosur kundër anabaptistëve; ata u detyruan të largoheshin nga qyteti dhe bashkë me ta edhe Mynceri. Kjo ndodhi në fund të vitit 1521.

Mynceri shkoi në Pragë dhe u përpoq që, duke u lidhur me elementët e lëvizjes husite që kishin shpëtuar gjallë, të vendosej këtu; por thirrja që ai shkroi veçse e detyroi të arratisej edhe nga Çekia. Në vitin 1522 u bë predikues në Alshtedt të Tyringisë. Këtu e filloi veprimtarinë e vet me reformën e kultit. Ai e hoqi fare latinishten qysh përpara se Luteri të kishte marrë guximin të shkonte kaq larg dhe urdhëroi që të lexoheshin jo vetëm ungjijtë e së dielës dhe kartat e apostujve, por e gjithë bibla. Në të njëjtën kohë organizoi propagandën në krahinat e afërta. Populli derdhej te ai nga të katër anët dhe brenda një kohe të shkurtër Alshtedti u bë qendër e lëvizjes popullore kundër priftërinjve në të gjithë Tyringinë.

Mynceri mbeti para së gjithash teolog; ai vazhdoi

t'i drejtonte goditjet e veta pothuajse vetëm e vetëm kundër priftërinjve. Ai nuk predikonte diskutimin e qetë dhe përparimin paqësor, siç bënte atëherë Luteri, por vazhdoi predikimet luftarake të mëparshme të Luterit, duke u bërë thirrje princërve dhe popullit të Saksonisë të hidheshin në luftë të armatosur kundër priftërinjve romanë.

> «Dhe Krishti thotë: «Unë nuk kam ardhur t'ju sjell paqen, por shpatën». Ç'duhet të bëni ju» (princër të Saksonisë) «me këtë shpatë? S'duhet të bëni gjë tjetër veçse të qëroni dhe të zhdukni të ligjtë që i presin rrugën ungjillit, në qoftë se dëshironi të jeni shërbëtorë të zotit. Krishti ka urdhëruar në mënyrë të prerë (Ungjilli pas Llukait, kap. 19, 27): «Sillini këtu armiqtë e mi dhe m'i rrihni përpara syve»... Lërini llomotitjet dhe mos thoni se gjoja forca e zotit duhet ta bëjë këtë pa ndihmën e shpatës suaj, se, përndryshe, ajo do të ndryshket në këllëf. Ata që kundërshtojnë zbulesën hyjnore duhen vrarë pa asnjë mëshirë, ashtu sikundër Ezekia, Kiri, Josia, Danieli dhe Ilia dërrmuan priftërinjtë e Baalit, sepse, përndryshe, kisha e krishterë nuk do të mund të kthehet në parimet e veta të para. Me afrimin e të korrave duhet të shkulen barërat e këqija nga vreshti i tënzot. Zoti ka thënë (Libri i pestë i Moisiut, kap. 7): «Mos kini mëshirë për të pafetë, shkatërrojini altaret e tyre, thyejini dhe digjini idhujt e tyre, që zemërimi im të mos bjerë mbi ju»».

Por këto thirrje drejtuar princërve qenë të kota, ndërsa zemërimi revolucionar në gjirin e popullit vazhdoi të rritej nga dita në ditë. Mynceri, idetë e të cilit po bëheshin gjithnjë më të qarta dhe gjithnjë më të guximshme, tani u shkëput përfundimisht nga reforma byrgere dhe që prej kësaj kohe filloi të vepronte haptazi si agjitator politik.

Doktrina e tij teologjike-filozofike drejtohej jo ve-

tëm kundër të gjitha dogmave themelore të katolicizmit, por edhe të krishterimit në përgjithësi. Në forma të krishtera ai predikonte panteizmin, i cili u përngjan çuditërisht pikëpamjeve spekulative të sotme[59] dhe në disa vende i afrohet edhe ateizmit. Ai nuk pranonte ta shikonte biblën si të vetmin burim të saktë të zbulesës. Zbulesa e vërtetë dhe e gjallë, sipas mendimit të tij, është arsyeja, zbulesë që ka ekzistuar në të gjitha kohët dhe në të gjithë popujt dhe që ekziston edhe sot. T'i kundërvije arsyes biblën donte të thoshte të mbysje frymën me shkronjën e vdekur, sepse fryma e shenjtë, për të cilën flet bibla, nuk është diçka që ekziston jashtë nesh; fryma e shenjtë është pikërisht arsyeja jonë. Besimi nuk është gjë tjetër veçse zgjim i arsyes te njeriu, dhe prandaj besim mund të kishin edhe paganët. Me anë të këtij besimi, me anë të arsyes që është zgjuar njeriu hyjnizohet e shenjtërohet. Prandaj parajsa nuk është diçka e asaj bote, ajo duhet kërkuar në këtë botë, dhe besimtarët duhet ta vendosin këtë parajsë, d.m.th. mbretërinë e zotit, këtu në tokë. Ashtu sikurse nuk ka parajsë në atë botë, në atë botë nuk ka as ferr dhe as mallkim të përjetshëm. Po ashtu nuk ka asnjë djall tjetër përveç pasioneve të këqija dhe epsheve të njeriut. Krishti ishte njeri si gjithë ne, profet dhe mësues, dhe misteri i kungimit, i krijuar prej tij, nuk është gjë tjetër veçse një darkë e zakonshme përkujtimore, në të cilën hahet bukë e pihet verë pa pasur asgjë mistike në të.

Këto pikëpamje Mynceri i predikonte, duke i veshur në pjesën më të madhe me po atë frazeologji të krishterë, me të cilën ishte detyruar të mbulohej për një kohë të gjatë edhe filozofia moderne. Por ideja themelore, thellësisht heretike, del kudo e theksuar në shkrimet e tij dhe ne e shohim qartë se kësaj mbulese biblike ai i jepte shumë më pak rëndësi se shumë dishepuj të Hegelit të kohëve të reja. Dhe megjithatë filozofinë moderne e ndajnë plot tre shekuj nga Mynceri.

Doktrina e tij politike lidhej ngushtë me këto pikëpamje fetare revolucionare dhe shkonte po aq larg përtej caqeve të atyre marrëdhënieve shoqërore dhe politike që ekzistonin atëherë, sa shkonte edhe teologjia e tij përtej caqeve të ideve që mbizotëronin në atë kohë. Sikundër filozofia fetare e Myncerit i afrohej ateizmit, edhe programi i tij politik ishte afër komunizmit, dhe bile në prag të revolucionit të shkurtit shumë sekte komuniste moderne nuk kishin një arsenal teorik aq të pasur, sa ai që kishin «përkrahësit e Myncerit» në shekullin XVI. Ky program, i cili ishte jo aq një përmbledhje e kërkesave të plebejve të atëhershëm, sa një anticipim gjenial i kushteve të çlirimit të elementëve proletarë, që sapo kishin filluar të zhvilloheshin në radhët e këtyre plebejve, kërkonte vendosjen e menjëhershme të mbretërisë së zotit mbi tokë — të mbretërisë mijëvjeçare të paralajmëruar nga profetët, — duke u kthyer kisha në gjendjen e saj të parë dhe duke i hequr të gjitha institucionet që ishin në kundërshtim me këtë kishë, që paskej ekzistuar në kohën e krishterimit të hershëm, por që në të vërtetë ishte një kishë krejt e re. Por me mbretërinë e zotit Mynceri nuk kuptonte gjë tjetër veçse një rend shoqëror, në të cilin nuk do të kishte më as dallime klase as pronë private as pushtet shtetëror të pavarur, të huaj për anëtarët e shoqërisë dhe që u kundërvihet atyre. Të gjitha autoritetet ekzistuese, në rast se nuk donin t'i nënshtroheshin revolucionit dhe të bashkoheshin me të, duhej të përmbyseshin, të gjitha punët dhe pasuritë të bëheshin të përbashkëta, të vendosej barazia më e plotë. Për t'i realizuar të gjitha këto jo vetëm në të gjithë Gjermaninë, por edhe në të gjithë botën e krishterë, duhej themeluar një Lidhje; princërve dhe fisnikëve duhej t'u propozohej që të bashkoheshin me të; në qoftë se nuk e bënin këtë, Lidhja që në rastin e parë të volitshëm duhej t'i përmbyste me armë ose t'i vriste.

Mynceri iu përvesh menjëherë punës për organizimin e kësaj Lidhjeje. Predikimet e tij bëheshin gjithnjë më të zjarrta dhe revolucionare. Duke mos u kufizuar vetëm me sulmet kundër priftërinjve, ai u hodh po me aq tërbim edhe kundër princërve, fisnikëve dhe patriciatit, u ngrit plot zemërim kundër shtypjes që ekzistonte dhe i kundërvuri asaj tablonë e vet fantastike të mbretërisë mijëvjeçare të barazisë sociale-republikane. Njëkohësisht ai nxirrte një pamflet revolucionar pas tjetrit, dërgonte në të gjitha anët emisarët e vet dhe vetë iu vu punës për organizimin e Lidhjes në Alshtedt e në rrethet e tij.

Fryti i parë i kësaj propagande qe shkatërrimi i kishës së vogël të shën Mërisë në Melerbah pranë Alshtedtit, sipas këtij urdhnimi: «Shkatërrojini altarët e tyre, thyejini kolonat e tyre, digjini idhujt e tyre, sepse ju jeni një popull i shenjtë» (Deut, kap. 7, 6). Princërit saksonë erdhën vetë në Alshtedt për t'u dhënë fund trazirave dhe urdhëruan të thirrej Mynceri në kështjellë. Këtu ai bëri një predikim të tillë, që ata nuk e kishin dëgjuar kurrë nga Luteri, nga ai «mish i qullët i Vitembergut», siç e quante atë Mynceri. Duke iu referuar dhiatës së re, ai kërkonte me këmbëngulje që eprorët e patenzonë, sidomos priftërinjtë dhe murgjit, që e shanin ungjillin si herezi, të shfaroseshin. Të patenzonët nuk kanë të drejtë të jetojnë përveçse për mëshirë të të zgjedhurve. Në qoftë se princërit nuk do t'i shfarosnin të patenzonët, zoti kishte për t'ua marrë atyre shpatën, *se forca e shpatës i përket gjithë komunitetit*. Fajtorët kryesorë për fajde, për vjedhje dhe për kusëri ishin princërit dhe fisnikët; ata përvetësojnë çdo gjë: peshkun në ujë, shpendët në ajër, gjithçka që prodhon toka. Dhe pas të gjitha këtyre ata edhe dalin e porosisin të varfrit: mos vidhni. Vetë ata rrëmbejnë çdo gjë që u bie në dorë, plaçkisin fshatarin e zejtarin, i rrjepin; këta të fundit mjafton të bëjnë fajin më të vogël

që t'i çojnë në litar, dhe për të gjitha këto doktor Lygneri* thotë: amin.

> «Zotërinjtë e kanë fajin vetë që i varfri bëhet armiku i tyre. Në qoftë se ata nuk duan t'i zhdukin shkaqet e kryengritjes, si kërkojnë ata që të rregullohet kjo punë? O zotërinj të nderuar, sa bukur do t'i thyejë zoti me purtekë të hekurt poçet e vjetra! Po jua them troç, unë do ta ngre peshë popullin. Lamtumirë!» (Kr. Cimerman. «Lufta fshatare», pj. II, f. 75[60]).

Mynceri e botoi predikimin e vet. Si dënim për këtë, tipografi, që e kishte shtypur në Alshtedt, me urdhër të dukës Johan të Saksonisë u detyrua të largohej nga vendi i tij dhe për të gjitha shkrimet e Myncerit u mor vendim që t'i nënshtroheshin censurës së qeverisë së dukës së Vajmarit. Por Mynceri nuk ia vuri veshin këtij urdhëri. Ai shtypi menjëherë në qytetin perandorak Mylhauzen një shkrim jashtëzakonisht rebel[61], në të cilin i bënte thirrje popullit që «ta zgjeronte të çarën, në mënyrë që gjithë bota të mund të shihte dhe të kuptonte se ç'janë zotërinjtë tanë të rëndë, të cilët kanë bërë një sakrilegj të tillë që zotin e kanë bërë një njeri të pikturuar me bojra». Këtë shkrim ai e përfundonte me fjalët:

> «E gjithë bota do të tronditet që nga themeli; punët do të marrin një rrugë të tillë që të patenzonët do të përmbysen dhe të përunjurit do të lartësohen».

Si epigraf «Tomas Mynceri me çekan» ka shkruar në faqen e titullit fjalët:

> «Dije, në gojën tënde unë vura fjalët e mia, unë të

* Lojë fjalësh: «*Lügner*» — «gënjeshtar» (Mynceri ka parasysh Luterin). *Red.*

vura ty sot mbi njerëzit dhe mbi mbretëritë, që ti të çrrënjosësh, të shkatërrosh, të zhdukësh e të shembësh e që ti të ndërtosh e të mbjellësh. Një mur i hekurt është ngritur kundër mbretërve, princërve, priftërinjve dhe kundër popullit. Le të hyjnë në luftë ata, dhe fitorja për mrekulli do të çojë në vdekjen e tiranëve të fuqishëm të patenzonë».

Prishja e Myncerit me Luterin dhe me partinë e tij kishte kohë që qe bërë një fakt i kryer. Vetë Luteri kishte qenë i detyruar të pranonte një sërë reformash të kishës, që Mynceri i kishte bërë pa e pyetur. Ai e shikonte veprimtarinë e Myncerit me nervozizmin dhe me mosbesimin e reformatorit të moderuar ndaj partisë më energjike e më radikale. Që në pranverën e vitit 1524 Mynceri i pat shkruar Melanhtonit, këtij prototipi të dijetarit filistin, të mykur e të shkëputur nga jeta, duke e akuzuar atë dhe Luterin se nuk e kuptonin fare lëvizjen dhe se përpiqeshin ta mbytnin atë me anë të besimit të verbër me germën e biblës dhe se gjithë doktrinën e tyre e kishte ngrënë tenja.

«Vëllezër të dashur, lërini pritjet dhe lëkundjet tuaja, erdhi koha, vera po troket në derë. Mos mbani miqësi me të patenzonët; ata nuk e lejojnë fjalën e zotit të veprojë me të gjithë forcën e vet. Mos i lajkatoni princërit tuaj se, përndryshe, do të gjeni vdekjen bashkë me ta. O ju, dijetarë të urtë të librave, mos më merrni inat, unë nuk mund të veproj ndryshe».

Luteri e kishte provokuar më se një herë Myncerin për të hyrë në diskutim me të, por ky i fundit, që qe i gatshëm ta pranonte luftën në çdo çast përpara popullit, nuk kishte aspak dëshirë të hynte në një diskutim teologjik përpara publikut jo të paanshëm të Universitetit të Vitembergut. Ai nuk dëshironte ta shndërronte «dëshminë e shpirtit në një privilegj të shkollës

së lartë». Në qoftë se Luteri ishte i sinqertë, le ta përdorte influencën e vet për t'u dhënë fund ndjekjeve që i bëheshin tipografit të Myncerit dhe censurës së vendosur mbi shkrimet e tij, në mënyrë që diskutimi të zhvillohej lirisht në shtyp.

Dhe ja, pas botimit të broshurës revolucionare të lartpërmendur të Myncerit, Luteri e paditi haptazi atë. Në «Letrën princërve saksonë kundër frymës së rebelimit», të botuar prej tij, Luteri e cilësonte Myncerin si vegël të djallit dhe u bënte thirrje princërve të ndërhynin dhe t'i përzinin nga vendi nxitësit e rebelimit. sepse ata nuk kufizohen vetëm me predikimin e pikëpamjeve të tyre të dëmshme, por bëjnë edhe thirrje për kryengritje dhe për t'i kundërshtuar me forcë autoritetet.

Më 1 gusht Mynceri duhej të përgjigjej përpara princërve në kështjellën e Vajmarit i akuzuar si nxitës i rebelimit. Kundër tij kishte fakte shumë kompromentuese: kishin rënë në gjurmët e Lidhjes së tij të fshehtë, kishin zbuluar se ai kishte gisht në formimin e shoqatave të minatorëve dhe të fshatarëve. E kërcënuan se do ta përzinin. Me t'u kthyer në Alshtedt, ai mori vesh se duka Georg i Saksonisë kërkonte dorëzimin e tij: ishin kapur letrat që ai i kishte shkruar me dorën e vet Lidhjes dhe në të cilat ai u bënte thirrje nënshtetasve të Georgit t'u kundërshtonin me armë armiqve të ungjillit. Sikur të mos ishte larguar nga qyteti, këshilli i qytetit do t'ia kishte dorëzuar dukës.

Ndërkaq rritja e zemërimit ndër fshatarët dhe ndër plebejtë e ndihmoi jashtëzakonisht propagandën e Myncerit. Për këtë propagandë Mynceri gjeti agjentë shumë të çmueshëm te anabaptistët. Anëtarët e këtij sekti, duke mos pasur kurrfarë dogmash pozitive të përcaktuara, të bashkuar vetëm nga opozita e përbashkët kundër të gjitha klasave sunduese dhe nga simboli i përbashkët i pagëzimit të dytë, të rreptë si asketë

në mënyrën e jetesës, të palodhur, fanatikë dhe të patrembur në agjitacionin e tyre, u bashkuan gjithnjë e më tepër rreth Myncerit. Duke mos pasur ndonjë vend qëndrimi të caktuar për shkak të ndjekjeve, ata endeshin nëpër gjithë Gjermaninë, duke predikuar kudo doktrinën e re, në të cilën Myncerи u sqaronte nevojat dhe aspiratat e tyre. Një numër shumë i madh prej tyre vdiqën nga torturat, u dogjën ose u vranë me mënyra të tjera; por burrëria dhe qëndresa e këtyre emisarëve mbeteshin të patundura dhe suksesi i veprimtarisë së tyre në kushtet e rritjes së shpejtë të zemërimit të popullit ishte jashtëzakonisht i madh. Prandaj, kur iku nga Tyringia, Mynceri e gjeti terrenin të përgatitur kudo dhe mund të drejtohej ku të donte.

Në Nuremberg, ku shkoi në fillim Mynceri[62], afërsisht një muaj para se të arrinte ai, ishte shtypur që në embrion një kryengritje fshatare. Mynceri filloi këtu një agjitacion të fshehtë; brenda një kohe të shkurtër filluan të dilnin njerëz që mbronin parimet teologjike më të guximshme të tij, se bibla nuk ishte e detyrueshme dhe se misteret nuk ishin asgjë; ata e deklaronin Krishtin një njeri të zakonshëm dhe pushtetin e zotërinjve laikë si pushtet të pafe. «Këtu bredh djalli, fryma e Alshtedtit!», — thirri Luteri. Këtu në Nuremberg Mynceri botoi përgjigjen që i jepte Luterit[63]. Ai e akuzoi haptazi atë se u bënte lajka princërve dhe se me qëndrimin e vet të lëkundshëm përkrahte partinë reaksionare. Por megjithatë populli prapëseprapë do të korrë fitoren dhe doktor Luteri do të katandiset atëherë si dhelpra e zënë në çark. — Këshilli e ndaloi këtë shkrim dhe Mynceri u shtrëngua të largohej nga Nurembergu.

Që këtej ai duke kaluar nga Shvabia u nis për në Alzasë, në Zvicër dhe përsëri në Shvarcvaldin e Epërm, ku para disa muajsh kishte shpërthyer një kryengritje, e cila ishte shpejtuar shumë nga emisarët e tij anabaptistë. Ky udhëtim propagandistik i Myncerit, pa dyshim,

ndihmoi shumë për organizimin e partisë popullore, për formulimin e saktë të kërkesave të saj dhe, më në fund, për fillimin e kryengritjes së përgjithshme në prill të vitit 1525. Këtu duken në mënyrë veçanërisht të qartë të dyja anët e veprimtarisë së Myncerit: nga njëra anë, midis popullit, me të cilin ai fliste me gjuhën e profecisë fetare, e vetmja gjuhë që kuptohej nga masat në atë kohë, dhe, nga ana tjetër — midis të iniciuarve, me të cilët ai mund të fliste hapur për qëllimet e veta të fundit. Në qoftë se edhe më parë, në Tyringi, ai kishte mundur të mblidhte rreth vetes një grup njerëzish nga më të vendosurit, të dalë jo vetëm nga populli, por edhe nga kleri i ulët, dhe t'i vinte në krye të Lidhjes së fshehtë, tani ai bëhet qendra e gjithë lëvizjes revolucionare të Gjermanisë Jugperëndimore, organizatori i një shoqate që shtrihej nga Saksonia dhe Tyringia, nëpër Frankoni dhe Shvabi, deri në Alzasë dhe në kufirin me Zvicrën. Tani ndër dishepujt e tij dhe udhëheqësit e Lidhjes ne shohim një varg të tërë agjitatorësh nga Gjermania Jugore, në pjesën më të madhe priftërinj revolucionarë: Hubmajerin në Valdshut, Konrad Grebelin nga Cyrihu, Franc Rabmanin në Grisen, Shapelerin në Memingen, Jakob Veen në Lajphajm, doktor Mantelin në Shtutgart. Ai vetë rrinte më shumë në Grisen, pranë kufirit të Shafhauzenit, duke shkuar prej këtej në krahinat Hegau, Kletgau etj. Ndjekjet e përgjakshme, që ndërmerrnin kudo princërit dhe fisnikët e shqetësuar kundër kësaj herezie të re të plebejve, ndihmuan mjaft për forcimin e frymës revolucionare dhe për shtrëngimin edhe më të madh të radhëve të kësaj organizate. Kështu Mynceri bëri agjitacion për rreth pesë muaj në Gjermaninë e Epërme; dhe kur u afrua çasti që komploti të vihej në jetë, ai u kthye në Tyringi, ku deshi ta drejtonte vetë kryengritjen dhe ku do ta gjejmë përsëri.

Ne do të shohim se sa drejt ishte pasqyruar në karakterin dhe në qëndrimin e këtyre dy udhëheqësve

pozita e vetë partive të tyre, do të shohim se si pavendosmëria e Luterit, frika e tij nga lëvizja që po merrte një karakter gjithnjë e më serioz dhe servilizmi burracak përpara princërve përputheshin me politikën e lëkundshme dhe me dy faqe të byrgerëve dhe se si energjia dhe vendosmëria revolucionare e Myncerit riprodhoheshin në pjesën më të zhvilluar të plebejve dhe të fshatarëve. I vetmi ndryshim ishte se, ndërsa Luteri mjaftohej vetëm me shprehjen e pikëpamjeve dhe të aspiratave të shumicës së klasës së vet dhe në këtë mënyrë kishte fituar në radhët e saj një popullaritet fare të parëndësishëm, Mynceri, përkundrazi, shkonte shumë më larg se konceptet e zakonshme dhe kërkesat imediate të plebejve e të fshatarëve dhe vetëm me një pjesë të zgjedhur të elementëve revolucionarë të asaj kohe krijoi një parti, e cila, në atë masë që qëndronte në nivelin e ideve të tij dhe që ishte po aq energjike, mbeti gjithnjë vetëm një pakicë e vogël e masës që kishte ngritur krye.

ENGELSI — MARKSIT

Rreth 24 majit 1853

...Dje lexova librin për mbishkrimet arabe, për të cilin të kam folur.[64] Ai nuk është pa interes, ndonëse të vjen ndot ngaqë në çdo rresht nxjerr kokën prifti dhe apologjeti i biblës.

Autori e quan një triumf të madh atë që paska mundur të zbulojë disa gabime në gjeografinë e lashtë të Gibonit, dhe prej këndej ai nxjerr konkluzionin se edhe teologjia e Gibonit gjithashtu nuk hyn në punë fare. Ky libër quhet «Gjeografia historike e Arabisë», e hartuar nga i ndjeri Çarls Forster. Konkluzionet më interesante që dalin prej tij janë këto:

1. Gjenealogjia e Noes, e Abrahamit etj. që gjoja jepet në Librin e Qenies është një numërim mjaft i saktë i fiseve beduine të asaj kohe sipas shkallës së afërsisë së dialekteve të tyre etj. Siç dihet, edhe sot e kësaj dite fiset beduine e quajnë veten Beni Saled, Beni Jusuf etj., d.m.th. bij të këtij apo atij. Të tillë emra, që rrjedhin nga mënyra e lashtë patriarkale e jetesës, në fund të fundit të çojnë në një gjenealogji të tillë. Lista e fiseve që jepet në Librin e Qenies konfirmohet pak a shumë edhe nga gjeografët e lashtë, ndërsa udhëtarët e kohës moderne dëshmojnë se këta emra të lashtë, ndonëse kanë ndryshuar sipas dialekteve lokale, në pjesën më të madhe vazhdojnë të ruhen edhe sot e kësaj dite. Nga kjo rrjedh se edhe vetë çifutët janë po ashtu një fis i vogël beduin, si të gjitha fiset e tjera, por që hynë në konflikt me beduinët e tjerë për shkak të kushteve të vendit, të bujqësisë etj.

2. Në lidhje me invazionin e madh arab, për të cilin folëm më parë, del e qartë se beduinët, ashtu si edhe mongolët, kanë kryer periodikisht invazione, se Mbretëria e Asirisë dhe ajo e Babilonisë kanë qenë themeluar nga fiset beduine pikërisht në atë vend ku më vonë lindi kalifati i Bagdadit. Themeluesit e Mbretërisë së Babilonisë, kaldejtë, vazhdojnë të ekzistojnë edhe sot e kësaj dite në të njëjtin vend me po atë emër Beni Haled. Qytetet e mëdha të Ninevisë dhe të Babilonisë lindën po aq shpejt, sa ç'u ngritën këtu e treqind vjet më parë qytete të tilla gjigante si Agra, Delhi, Lahora, Mutani në Indinë Lindore, si rezultat i një invazioni të fiseve afgane ose tartare. Pra, invazioni mysliman humbet shumë nga karakteri i vet i veçantë.

3. Arabët, me sa duket, aty ku kanë pasur vendqëndrimin e tyre të përhershëm, në jugperëndim, kanë qenë një popull po aq i qytetëruar sa edhe egjiptianët, asirianët etj.; këtë e provojnë ndërtimet e tyre arkitektonike. Ky fakt gjithashtu na shpjegon shumë gjëra në invazionin mysliman. Përsa i përket mashtrimit fetar, mund të themi se nga mbishkrimet e lashta të arabëve të jugut, në të cilat vazhdon të mbizotërojë tradita e vjetër kombëtare arabe e monoteizmit (si te indianët e Amerikës), ku monoteizmi çifut s'është veçse një *pjesëz e vogël* e saj, — nga këto mbishkrime të vjetra del, siç shihet, se revolucioni që bëri Muhameti në fe, si *çdo* lëvizje tjetër fetare, ka qenë *formalisht një reaksion,* një kthim i rremë prapa drejt së vjetrës, drejt së thjeshtës.

Tani unë e kam fare të qartë se të ashtuquajturat shkrime të shenjta të çifutëve nuk janë gjë tjetër veçse një regjistrim i traditave fetare dhe fisnore të arabëve të vjetër, të cilat pësuan ndryshime për shkak të shkëputjes së hershme të çifutëve nga fqinjët e tyre të të njëjtit trung, por që mbetën nomadë. Fakti që Palestinën nga ana arabe e rrethon një shkretëtirë që është vendi i beduinëve, shpjegon zhvillimin e saj. Por mbi-

shkrimet e vjetra arabe, traditat dhe kurani[65], gjithashtu lehtësia, me të cilën shtëllisen të gjitha gjenealogjitë etj., — të gjitha këto provojnë se përmbajtja kryesore ka qenë arabe ose më sak përgjithësisht semite, ashtu si te ne «Eda» dhe eposi heroik gjerman.

Yti *F.E.*

MARKSI — ENGELSIT

2 qershor 1853

... Letrën tënde mbi çifutët dhe arabët e lexova me interes të madh. Ndër të tjera: 1) Te të gjitha fiset orientale mund të vihet re se që nga fillimi i historisë ekziston një raport i *përgjithshëm* midis jetës sedentare të një pjese dhe nomadizmit të vazhdueshëm të pjesës tjetër. 2) Në kohën e Muhametit rruga tregtare nga Evropa në Azi ndryshoi shumë, dhe qytetet e Arabisë, të cilat më parë bënin tregti të madhe me Indinë etj., patën një rënie në tregti; sigurisht, edhe kjo qe një shtytje. 3) Përsa i përket fesë, kjo mund të përmblidhet në pyetjen e përgjithshme, së cilës mund t'i përgjigjemi lehtë: pse historia e Lindjes *duket* si një histori fesh?

Në çështjen e formimit të qyteteve të Lindjes s'ka gjë më të shkëlqyer, konkrete e të qartë sesa libri i plakut Fransua Bernje (ai ka qenë nëntë vjet mjek i Aurangzebit): «Udhëtime që përmbajnë përshkrimin e shtetit të Mogolit të Madh etj.». Ai përshkruan gjithashtu shumë mirë organizimin ushtarak, mënyrën e furnizimit me ushqime të këtyre ushtrive të mëdha etj. Në lidhje me këto ai thotë ndër të tjera:

> «Bërthamën kryesore e përbën kavaleria, këmbësoria nuk është aq e madhe sa ç'e bëjnë, po të mos ngatërrojmë me luftëtarët e vërtetë të gjithë shërbëtorët dhe tregtarët që ndjekin pas ushtrinë. Edhe po t'i llogaritësh të gjithë, mendoj se vetëm në ushtrinë që ndjek mbretin mund të numërosh me të drejtë dyqind a treqind mijë vetë dhe ngandonjëherë edhe më shumë, për shembull, në ato raste kur mendohet se mbreti do të ikë nga kryeqyteti për një kohë të gjatë. Të gjitha këto prapëseprapë nuk e habisin atë që e di se sa shumë çadra, kuzhina, veshje, lloj-lloj plaçke, shpesh edhe gra e, pra, edhe elefantë, deve, qe, kuaj, hamej, furnizues të ushqimit për kafshët e për njerëzit, tregtarë të çdo kategorie e shërbëtorë lëvizin së bashku me këto ushtri; të gjitha këto nuk i habisin ata që e njohin gjendjen dhe qeverisjen origjinale të vendit, nuk i habisin ata që e dinë se *mbreti është i vetmi pronar i të gjitha tokave* në shtet, prej nga rrjedh në mënyrë të pashmangshme fakti që *kryeqytete* të tëra si Delhi apo Agra jetojnë pothuajse krejtësisht në kurriz të ushtrisë dhe prandaj janë të detyruar të ndjekin mbretin, kur ai niset për njëfarë kohe në marshim. Këto qytete nuk i ngjajnë fare Parisit, *në thelb ato janë kampe ushtarake*, veçse të ndërtuara e të vendosura pak më mirë se kampet e ngritura në fushë».

Në lidhje me marshimin e Mogolit të Madh në Kashmir me një ushtri prej 400 000 vetësh etj. ai thotë:

> «Gjëja e vështirë është të kuptosh me se dhe si mund të ushqehet në marshim një ushtri kaq e madhe, një mori kaq e madhe njerëzish e kafshësh. Për të kuptuar këtë gjë mjafton të supozosh, siç është edhe në të vërtetë, se indianët janë shumë të matur në të ngrënë dhe kënaqen me pak dhe se nga e gjithë kjo masë e madhe kalorësish një e dhjeta ose bile një e njëzeta ha mish në marshim. Ata kënaqen me kiçrinë e tyre — një përzierje orizi të zier me zarzavate, gatuar me gjalp të tretur. Duhet pasur parasysh gjithashtu edhe fakti që devetë janë shumë rezistente në punë dhe e përballojnë me lehtësi urinë dhe etjen; atyre u mjafton pak ushqim dhe për më tepër hanë çdo gjë. Kur bëhen ndalesa, ushtarët i lëshojnë devetë të kullosin aty afër ku hanë ç'gjejnë. Përveç kësaj, tregtarët që kanë dyqane në Delhi janë të detyruar t'i mbajnë ato edhe në marshim, po kështu edhe tregtarët

e vegjël etj... Së fundi, që të gjejnë ushqim për kafshët këta varfanjakë lëshohen nëpër fshatrat rreth e rrotull për të blerë aty ndonjë gjë dhe për të nxjerrë pastaj nga kjo ndonjë fitim. Zanati i tyre i zakonshëm dhe kryesor është që me anë të një lloj rashqeli të mbledhin barin e vyshkur me kohë nga fushat e mëdha, ta lajnë ose ta shkundin dhe pastaj ta sjellin për t'ia shitur ushtrisë...»

Bernjeja me të drejtë vëren se themelin e të gjitha fenomeneve në Lindje (ai e ka fjalën për Turqinë, Persinë, Industanin) e përbën *mungesa e pronës private mbi tokën*. Ky është kyçi i vërtetë edhe për qiellin e Lindjes...

ENGELSI — MARKSIT

6 qershor 1853

...Mungesa e pronës private mbi tokën është me të vërtetë kyçi për të kuptuar të gjithë Lindjen. Këtu e ka bazën e gjithë historia politike dhe ajo fetare. Po përse popujt e Lindjes nuk arritën të vendosnin pronën private mbi tokën, bile as atë feudale? Mua më duket se ky fakt shpjegohet kryesisht me klimën dhe me karakterin e tokës, sidomos me sipërfaqet e mëdha të shkretëtirave, që shtrihen nga Saharaja nëpër Arabi, Persi, Indi e Tatari e deri te pjesa më e lartë e rrafshnaltës aziatike. Kushti i parë për zhvillimin e bujqësisë këtu është ujitja artificiale, por këtë gjë e bëjnë ose komunat ose provincat ose qeveria qendrore. Qeveritë e Lindjes kanë pasur gjithnjë vetëm tri dikastere: atë të Financave (grabitja e vendit të vet), të Luftës (grabitja e vendit të vet dhe e vendeve të huaja) dhe të Punëve Botore (kujdesi për riprodhimin). Qeveria britanike në Indi ka organizuar Nr. 1 e Nr. 2, duke u dhënë atyre një trajtë më filistine, kurse Nr. 3 e ka lënë fare pas dore; kjo ka bërë që bujqësia indiane të marrë rrugën e shkatërrimit. Konkurrenca e lirë atje nuk pati fare sukses. Pjelloria e tokës rritej me metoda artificiale, por ajo binte me dobësimin e sistemit ujitës; kështu shpjegohet edhe fakti i çuditshëm që krahina të tëra, dikur të lëruara për bukuri, tani janë braktisur e janë lënë të shkreta (Palmiri, Petra, gërmadhat e Jemenit e shumë lokalitete në Egjipt, në Persi e në Industan). Kështu shpjegohet edhe fakti që mjaftonte një luftë shfarosëse që një vend të mbetej i shkretë dhe të zhdukej qytetërimi i tij për qindra vjet. Në këtë kategori fenome-

nesh hyn, për mendimin tim, edhe zhdukja e tregtisë së Arabisë Jugore në periudhën para Muhametit, të cilën ti me të drejtë e quan si një nga momentet më të rëndësishme të revolucionit mysliman. Unë nuk e njoh aq mirë historinë e tregtisë së gjashtë shekujve të parë të epokës së krishterë që të gjykoj se në ç'masë kushtet e përgjithshme materiale botërore kanë ndikuar që në vend të rrugës tregtare përmes Detit të Kuq të preferohej rruga tregtare përmes Persisë në Detin e Zi dhe përmes Gjirit Persik në Siri e në Azinë e Vogël. Por sidoqoftë një rol të madh ka luajtur fakti se në Mbretërinë Persiane të Sasanidëve të organizuar mirë karvanet udhëtonin pothuajse pa u rrezikuar, ndërsa Jemeni prej vitit 200 deri në vitin 600 pothuajse vazhdimisht gjendej nën robërinë e abisinasve, që e pushtonin dhe e plaçkisnin vendin. Qytetet e Arabisë Jugore, që lulëzonin që nga koha e romakëve, në shekullin VII ishin shndërruar në grumbuj të shkretë gërmadhash. Beduinët fqinjë këta 500 vjet thurën legjenda thjesht mistike, përrallore mbi prejardhjen e tyre (shih Kuranin e historianit arab Novairi), kurse alfabeti i përdorur për mbishkrimet në këto qytete nuk njihej pothuaj fare, ndonëse *nuk kishte alfabet tjetër*, kështu që në fakt *çdo lloj shkrimi* ishte harruar. Të tilla fenomene të japin shkas të arrish në përfundimin se krahas rënies, të shkaktuar nga kushtet e përgjithshme tregtare, ka ndodhur edhe shkatërrimi i drejtpërdrejtë me dhunë, që mund të shpjegohet vetëm me invazionin e etiopasve. Dëbimi i abisinasve ka ndodhur 40 vjet para Muhametit; ky ka qenë akti i parë i ndjenjës kombëtare arabe, që po zgjohej e po rritej gjithnjë e më tepër për shkak të invazioneve të persëve që vinin nga veriu e që qenë afruar deri në Mekë. Studimit të historisë së Muhametit unë do t'i përvishem vetëm këto ditë. Tani për tani mua më duket se kjo histori ka karakterin e një reaksioni beduin kundër fellahëve qytetarë vendas në rrënim e sipër, të cilët edhe nga pikëpamja fetare ishin mjaft të përçarë dhe

feja e të cilëve ishte një përzierje e kultit të natyrës me judaizmin që po shthurej dhe me krishterimin.

Fragmentet e plakut Bernje janë me të vërtetë shumë të bukura. Është kënaqësi e madhe të lexosh përsëri diçka të shkruar nga një francez i vjetër, objektiv, i arsyeshëm, i cili gjithnjë godet në shenjë, pa e bërë veten se këtë ai e kupton...

K. MARKS

LËVIZJA KUNDËR KISHËS — DEMONSTRATA NË HAJD-PARK

Londër, 25 qershor 1855

Një e vërtetë e vjetër, e provuar nga historia, thotë se forcat shoqërore, të cilave u ka kaluar koha — forca që vetëm sa për emër mbajnë ende të gjitha atributet e pushtetit, ndonëse themelet ku mbështeten ato janë kalbur prej kohe, dhe që vazhdojnë të vegjetojnë, sepse, edhe më parë se të shpallet vdekja dhe të hapet testamenti, trashëgimtarët janë kërleshur midis tyre për shkak të trashëgimit, — tendosen edhe një herë para agonisë, kalojnë nga mbrojtja në sulm, në vend që t'i shmangen luftës, e kërkojnë vetë luftën, duke u munduar të nxjerrin konkluzionet më ekstreme nga premisa, të cilat jo vetëm që janë të dyshimta, por edhe janë dënuar prej kohe nga historia. E tillë është tani oligarkia angleze. E tillë është edhe motra e saj binjake — *kisha*. Po bëhen orvatje të panumërta për të bërë një riorganizim brenda kishës zyrtare anglikane, si të kishës «së lartë», ashtu edhe të kishës «së ulët»[66], orvatje për të zgjidhur mosmarrëveshjet me disidentët[67], me qëllim që përballë masës mëkatare të kombit të vihet një forcë kompakte, po zbatohen me shpejtësi njëra pas tjetrës masa të detyrimit fetar. Konti i përshpirtshëm Sheftsberi, i njohur më parë si lord Eshli, konstatoi me dëshpërim në Dhomën e Lordëve se vetëm në Angli pesë milionë njerëz janë larguar fare jo vetëm nga kisha, por edhe nga krishterimi. «*Compelle intrare*»*, përgjigjet kisha zyrtare. Ajo ua lë lordt Eshlit dhe disidendëve si ai, fanatikëve sektarë dhe histerikë, të nxjerrin për të gështenjat nga zjarri.

E para masë detyrimi fetar ishte «bili i birrës», në bazë të të cilit të dielave ndalohej hapja e lokaleve publike të dëfrimit, veçse prej orës 6 deri në orën 10 të mbrëmjes. Ky bil u aprovua kontrabandë në fund të një seance, kur dhoma ishte gati fare bosh dhe pasi zotërinjtë e përshpirtshëm kishin siguruar përkrahjen e pronarëve të birrarive të mëdha të Londrës, duke u premtuar se do t'ia zgjatnin jetën sistemit të patentave, d.m.th. duke u premtuar se do të ruhej monopoli i kapitalit të madh. Pas këtij erdhi bili mbi ndalimin e tregtisë të dielave, i cili tani u lexua për herë të tretë në Dhomën e Komuneve dhe disa pika të të cilit sapo u diskutuan në komisionin e të dyja dhomave. Edhe për këtë masë të re detyrimi u sigurua përkrahja e kapitalit të madh, pasi të dielave tregtojnë vetëm dyqanet e vogla, ndërsa magazinat e mëdha janë gjithnjë gati ta mënjanojnë me rrugë parlamentare konkurrencën që u bëjnë të dielave dyqanet e vogla. Në të dyja rastet kemi të bëjmë me një komplot midis kishës dhe monopolit të kapitalit, dhe në të dyja rastet ligjet ndëshkuese fetare drejtohen kundër klasave më të ulëta, për të qetësuar ndërgjegjen e klasave më të larta. *Bili i birrës* i preku po aq pak klubet aristokratike, sa ç'preku *bili mbi tregtinë e të dielave* punët e klasave të privilegjuara të dielave. Klasa punëtore e merr pagën të shtunën në mbrëmje. Pra, të dielave tregtia bëhet vetëm për të, vetëm ajo është e detyruar t'i blejë të dielave ato pak gjëra që i nevojiten. Prandaj edhe bili i ri drejtohet vetëm kundër saj. Në shekullin XVIII aristokracia franceze thoshte: ne kemi Volterin, populli ka meshën dhe të dhjetën. Në shekullin XIX aristokracia angleze thotë: ne kemi frazat hipokrite,

* — «Bindi të vijnë...» (shprehje e ungjillit). *Red.*

populli — punët e krishterimit. Shenjtorët klasikë të krishterimit mundonin trupin *e tyre* për të shpëtuar shpirtin e masës; shenjtorët e sotëm me kulturë mundojnë *trupin e masës* për të shpëtuar shpirtin e vet.

Kjo aleancë e aristokracisë së korruptuar, të kalbur, të etur për dëfrime, me kishën, aleancë që është mbështetur në llogaritë e ndyra që bëjnë për të nxjerrë fitime manjatët e birrës dhe tregtarët e mëdhenj monopolistë, shkaktoi dje një *demonstratë të përgjithshme* aq të madhe në Hajd-park, që s'e kishte parë Londra pas vdekjes së Gjergjit IV, të këtij «xhentëlmeni të parë të Evropës». Ne e ndoqëm këtë demonstratë nga fillimi deri në mbarim dhe mendojmë se nuk do ta tepronim, po të thoshim *se dje në Hajd-park filloi revolucioni anglez*. Lajmet e fundit, që erdhën nga Krimeja, luajtën rolin e një fermenti që ndikoi shumë mbi këtë demonstratë *«joparlamentare»*, *«jashtëparlamentare»* dhe *«antiparlamentare»*.

Lord Robert Grovnori, autor i bilit mbi tregtinë e të dielave, kur i thanë se ligji i tij drejtohet vetëm kundër të varfërve, e jo kundër të pasurve, u përgjigj kështu:

> «Aristokracia përpiqet mjaft që të mos i ngarkojë me punë të dielave shërbëtorët dhe kuajt e vet».

Në fund të javës së kaluar mbi të gjitha muret e Londrës mund të shihje këtë pllakatë të shtypur me germa të mëdha, të botuar nga *çartistët:*

> *«Bili i ri i të dielave* ndalon leximin e gazetave, të rruajturit, të pirit duhan, të ngrënit, të pirit dhe të gjitha ato lloje ushqimi e pushimi, fizik e shpirtëror, që gëzojnë ende të varfrit. Të diel pasdreke në Hajd-park, *nën qiellin e hapët*, do të mbahet një *miting* i zejtarëve, i punëtorëve dhe i përfaqësuesve të tjerë të *«shtresave të ulëta»* të kryeqytetit për t'u bindur se me sa përshpirtni e ruan aristokracia porosinë mbi ditën e pushimit dhe sa kujdeset ajo që të mos i ngarkojë këtë ditë me punë shërbëtorët dhe kuajt e vet (shih fjalimin e lord Grovnorit). Mitingu do të mbahet në orën tre në bregun e djathtë të Serpentinës (lumë i vogël në Hajd-park), në rrugën që çon për në Kopshtet e Kensingtonit. Ejani dhe merrni me vete gratë e fëmijët, që ata të mund të nxjerrin mësime nga shembulli që u japin «klasat *më të mira!*»»

Duhet pasur parasysh se siç është *Lonshani** për parizianët, ashtu është pikërisht edhe rruga gjatë Serpentinës në Hajd-park për *haute volée*** angleze një vend ku ata pasdreke, sidomos të dielave, organizojnë një paradë të karrocave dhe të veshjeve të tyre luksoze, duke kaluar mbi kuaj të shoqëruar nga një shumicë e madhe shërbëtorësh. Nga pllakata e mësipërme mund të shihet se lufta kundër klerikalizmit po merr një karakter të tillë, si edhe çdo luftë serioze në Angli, — karakterin e *luftës së klasës* të të varfërve kundër të pasurve, të popullit kundër aristokracisë, të klasave «të ulëta» kundër klasave «më të mira».

Aty nga ora tre pasdite në vendin e caktuar, në bregun e djathtë të Serpentinës, në livadhet e pafund të Hajd-parkut u mblodhën rreth 50 000 vetë. Dalngadalë numri i të ardhurve, në saje të lumit të njerëzve që derdhej nga bregu i majtë, u rrit duke arritur të paktën në 200 000. Mund të shihej se si shtyheshin ata me grupe të tëra nga një vend në tjetrin. Konsteblët*** e shumtë që ishin radhitur mundoheshin haptazi t'ua hiqnin organizatorëve të mitingut atë që kërkonte Arkimedi për të përmbysur botën, — pikën e mbështetjes. Më në fund, një turmë më e madhe zuri një vend, dhe çartisti *Blaj* hipi si kryetar në një vend pakëz më

* Vend shëtitjesh dhe hipodrom në periferi të Parisit. *Red.*

** — shtresën e lartë. *Red.*

*** — vjen nga fjala anglishte *constable* — polic. *Red. Përkth.*

të ngritur në mes të kësaj turme. Por sapo filloi të flasë, u afrua inspektori i policisë Banks në krye të 40 konstablëve që tundnin shkopinjtë dhe deklaroi se parku ishte pronë private *mbretërore* dhe se këtu nuk mund të mbahej mitingu. Filluan disa bisedime të shkurtra, gjatë të cilave Blaji u përpoq të provonte se parku ishte pronë publike; pas këtyre fjalëve Banksi tha se ai kishte marrë urdhër ta arrestonte Blajin, në qoftë se ai do të ngulte këmbë në të tijën. Atëherë Blaji thirri i shoqëruar nga protesta e zemëruar e turmës:

> «Policia e madhërisë së saj deklaron se Hajd-parku është pronë private e mbretëreshës dhe madhëria e saj nuk dëshiron t'i vërë tokat e veta në dispozicion të popullit për mitingjet e tij. Prandaj ne do të shkojmë në Pazarin e Oksfordit».

Turma me thirrje ironike: *«God save the Queen!»** u nis nëpër rrugë të ndryshme drejt Pazarit të Oksfordit. Por në këtë kohë *Finleni*, anëtari i komitetit ekzekutiv të çartistëve, u gjend i hedhur rrëzë një druri që ndodhej pak më larg. Masat e popullit që i shkuan pas e qarkuan menjëherë me një rreth aq të ngushtë e të ngjeshur, saqë policia hoqi dorë nga orvatja për të vënë dorë mbi të.

> «Gjashtë ditë në javë na shtypin, — tha ai, — dhe parlamenti kërkon të na e rrëmbejë edhe atë çikë liri që gëzojmë ditën e shtatë. Oligarkët dhe kapitalistët, së bashku me priftërinjtë që perëndojnë sytë, kërkojnë që mëkatin për vrasjen e paturpshme të bijve të popullit, që ata bënë fli në Krime, ta lajmë ne, e jo ata».

* — «Zoti e ruajtë mbretëreshën!» *Red.*

Ne e lamë këtë grup me qëllim që t'i afroheshim një grupi tjetër, ku oratori i shtrirë krejt përtokë fliste përpara auditorit të tij në këtë pozicion horizontal. Përreth nga të katër anët u dëgjuan zëra: «Të dalim te rruga, te karrocat!». Ndërkaq filluan të dëgjoheshin tallje fyese që u drejtoheshin atyre që ishin në karroca dhe kaluar. Konstablët, të cilëve u vinin vazhdimisht përforcime nga qyteti, mundën ta largonin pakëz nga rruga turmën e shëtitësve. Në këtë mënyrë ata bënë që për më tepër se një çerek ore rrugë në të dy anët e rrugës, që nga Apslihauzi nëpër Rotenrou gjatë Serpentinës deri te Kopshtet e Kensingtonit, të radhiteshin rreshta të dendur njerëzish. Afërsisht dy të tretat e publikut ishin punëtorë, një e treta — përfaqësues të borgjezisë, të gjithë me gra e me fëmijë. Lejdit dhe xhentëlmenët elegantë, anëtarët e Dhomës së Komuneve dhe të Dhomës së Lordëve, të hipur në karroca të larta parade, me shërbëtorë të veshur me livre prapa dhe përpara, kalorësit moshëthyer, të nxehur nga vera, gjithë këta aktorë padashka këtë radhë nuk ia kishin edhe aq ngenë paradës. Ata u detyruan të kalonin si të dënuar midis dy rreshtash fshikulluesish. Një breshër i tërë fjalësh tallëse, ironike, fyese, me të cilat anglishtja është më e pasur se çdo gjuhë tjetër, ra mbi ta nga të dyja anët. Meqenëse koncerti ishte i improvizuar, veglat muzikore mungonin. Prandaj korit iu desh të shfrytëzonte ato mundësi që kishte dhe u kufizua me një muzikë vokale. E ç'koncert ferri doli nga kombinimi i gjithë atyre britmave, fishkëllimave, zhurmave, zërave të ngjirur, përpjekjeve të këmbëve, shfryrjeve, ulërimave, klithmave, rënkimeve, të thirrurave dhe kërcënimeve! Kjo ishte një muzikë që mund t'i bënte njerëzit të çmendeshin dhe që mund të zgjonte edhe gurin. Një përzierje e çuditshme humori të vërtetë të vjetër anglez dhe tërbimi të përmbajtur prej një kohe të gjatë që tani ziente: *«Go to the church!»* («Shkoni në kishë!») — ishte e vetmja thirrje e artikulluar që

mund të dalloje. Njëfarë lejdi, për të vënë qetësinë, zgjati nga karroca një libër lutjesh të lidhur me përshpirtni. «*Give it to read to your horses!*» («Jepuani kuajve tuaj ta lexojnë!») — buçiti si jehonë përgjigjja e mijëra zërave. Sa herë që kuajt e trembur ngriheshin mbi këmbët e prapme, hidhnin shkelma ose lëshoheshin, duke vënë në rrezik jetën e ngarkesës së tyre elegante, thirrjet tallëse bëheshin edhe më të fuqishme, më kërcënuese dhe të pamëshirshme. Lordët dhe lejdit fisnike, midis të cilëve edhe kontesha Granvil, e shoqja e ministrit dhe e kryetarit të këshillit të fshehtë, u detyruan të dilnin nga karrocat dhe të përdornin këmbët e tyre. Kur kalonin hipur mbi kuaj, xhentëlmenët e nderuar, veshja e të cilëve, sidomos kapelat e tyre të mëdha, duhej të dëshmonte për një përshpirtni të veçantë, të gjithë këta zëra të tërbuar, si me komandë, ktheheshin në të qeshura të papërmbajtshme. Njëri nga këta xhentëlmenë e humbi durimin. Ai, si Mefistofeli, bëri një gjest të pahijshëm — i nxori gjuhën kundërshtarit. «*He is a wordcatcher, a parliamentary man! He fights with his own weapons!*» («Është një llafazan, anëtar i parlamentit! Lufton me armën që ka!» — u dëgjua nga njëra anë e rrugës. «*He is a Saint! He is psalm singing!*» («Është shenjtor! Këndon psallmet!») — u përgjigjën nga ana tjetër.

Në këtë kohë me anë të telegrafit të qytetit u njoftuan të gjitha postat e policisë se në Hajd-park është duke u përgatitur një revoltë dhe u dha urdhri që të niseshin për në vendin e veprimeve ushtarake. Lidhur me këtë në intervale të shkurtra kohe erdhën njëri pas tjetrit reparte policie, të cilat parakaluan përmes murit të dyfishtë të njerëzve që ishin rreshtuar që nga Apslihauzi deri te Kopshtet e Kensingtonit. Çdo repart pritej me fjalët e këngës popullore — «*Where are gone the geese? Ask the police!*» («Ç'u bënë patat? Pyetni policinë!») — që bënte aluzion për patat që pat vjedhur jo shumë kohë më parë një konstebl në Klerkenuel.

Kjo shfaqje vazhdoi tri orë. Vetëm mushkëritë angleze mund të bëjnë një heroizëm të tillë. Gjatë kohës që vazhdoi demonstrata, midis grupeve të ndryshme dëgjoheshin këto fjalë: «Ky është vetëm fillimi!» «Ky është vetëm hapi i parë!» «Ne i urrejmë ata!» etj. Ndërsa fytyrat e punëtorëve shprehnin zemërim, në fytyrat e borgjezëve dukej një buzëqeshje lumnie të vetëkënaqur që s'ishte parë kurrë. Aty nga fundi zemërimi i demonstruesve u shtua. Të pranishmit filluan të tundnin shkopinjtë, duke iu kanosur karrocave, dhe zhurma e pambaruar u shkri në një thirrje të vetme: «*You rascals!*» («Të poshtër!») Çartistet dhe çartistët e palodhur për tri orë rresht brodhën në mes të masës, duke shpërndarë trakte, ku ishte shtypur me germa të mëdha:

> «*Riorganizimi i çartizmit!* Të martën e ardhshme, më 26 qershor, në sallën e Institutit të Letërsisë dhe të Shkencës në Frajar-strit, Doktorskomons, do të mbahet një mbledhje e madhe publike. Kjo mbledhje do të bëhet për zgjedhjen e delegatëve që do të marrin pjesë në konferencën e riorganizimit të çartizmit në kryeqytet. Hyrja është e lirë».

Sot shumica e organeve të shtypit të Londrës jep vetëm disa lajme të shkurtra mbi ngjarjet e Hajd-parkut. Asnjë gazetë, me përjashtim të «Morning Post» të Palmerstonit, nuk ka botuar ende një kryeartikull.

> «Skena jashtëzakonisht të turpshme dhe të rrezikshme, — shkruan ky organ, — «u zhvilluan në Hajd-park; fyerje e hapët e ligjit dhe e mirësjelljes, ndërhyrje e paligjshme me forcë në fushën e veprimtarisë së lirë të pushtetit ligjdhënës. Rreziku që këto skena të përsëriten të dielën e ardhshme duhet të mënjanohet».

Njëkohësisht kjo gazetë shpall, megjithatë, si të vetmin fajtor «përgjegjës» për çrregullimet që ndodhën lordin «fanatik» Grovnor, duke e akuzuar se ngjalli «zemërimin e drejtë të popullit». Sikur nuk u lexua tri herë bili i Grovnorit në parlament para se të aprovohej! Apo, mbase, edhe lordi fisnik veproi «me forcë mbi veprimtarinë e lirë të pushtetit ligjdhënës»?

K. MARKS

KAPITALI, VËLL. I

[*Fragmente*[68]]

...Për shoqërinë e prodhuesve të mallrave, ku raporti shoqëror i përgjithshëm i prodhimit qëndron në faktin se prodhuesit këtu i krahasojnë produktet e tyre të punës si mallra, pra si vlera, dhe në këtë formë sendore punët e tyre private krahasohen me njëra-tjetrën si punë njerëzore e njëllojtë, — për një shoqëri si kjo forma më e përshtatshme e fesë është krishterimi me kultin e tij të njeriut abstrakt, veçanërisht në tipet e tij borgjeze, si protestantizmi, deizmi etj. Në mënyrat e prodhimit të Azisë së Vjetër, të kohës antike në përgjithësi, shndërrimi i produktit në mall, pra edhe qenia e njerëzve si prodhues mallrash luajnë një rol të dorës së dytë, i cili megjithatë bëhet aq më i rëndësishëm, sa më thellë futen komunat në fazën e shkatërrimit të tyre. Popuj tregtarë të mirëfilltë ka vetëm në hapësirat ndërbotërore të botës së vjetër, si perënditë e Epikurit, ose si çifutët në poret e shoqërisë poloneze. Këta organizma të lashtë shoqërorë prodhimi janë shumë më të thjeshtë dhe më të qartë sesa organizmi borgjez, por ata mbështeten ose në papjekurinë e njeriut individual, i cili ende nuk është shkëputur nga kërthiza e lidhjeve të natyrshme të gjinisë që e bashkojnë me të tjerët, ose në marrëdhëniet e drejtpërdrejta të sundimit dhe të nënshtrimit. Kushti i ekzistencës së tyre është shkalla e ulët e zhvillimit të forcave prodhuese të pu-

nës dhe kufizimi përkatës i marrëdhënieve të njerëzve brenda caqeve të procesit material të prodhimit të jetës, pra, karakteri i kufizuar i të gjitha marrëdhënieve të tyre me njëri-tjetrin dhe me natyrën. Ky kufizim real pasqyrohet idealisht në fetë e lashta, që hyjnizojnë natyrën, dhe në besimet popullore. Pasqyrimi fetar i botës reale mund të zhduket në përgjithësi vetëm atëherë kur marrëdhëniet e jetës së përditshme praktike të njerëzve do të shprehen në lidhjet e tyre të tejdukshme dhe të arsyeshme me njëri-tjetrin dhe me natyrën. Sistemi i procesit të jetës shoqërore, d.m.th. i procesit material të prodhimit, do ta flakë tutje vellon e mjegullës mistike vetëm atëherë kur të bëhet produkt i njerëzve të bashkuar lirisht në shoqëri dhe të gjendet nën kontrollin e tyre të vetëdijshëm dhe sistematik. Mirëpo kjo kërkon që shoqëria të ketë një bazë materiale ose të ketë një sërë kushtesh materiale ekzistence, të cilat nga ana e tyre janë produkt i natyrshëm i një procesi zhvillimi të gjatë e të mundimshëm.

Ç'është e vërteta, ekonomia politike e ka analizuar — ndonëse në mënyrë të pamjaftueshme — vlerën dhe madhësinë e vlerës dhe ka zbuluar përmbajtjen që fshehin këto forma. Por ajo asnjëherë as që e ka bërë pyetjen: pse kjo përmbajtje merr një formë të tillë, me fjalë të tjera — pse puna shprehet në vlerën dhe koha që vazhdon puna, si masë e saj, — në madhësinë e vlerës së produktit të punës? Formulat, të cilat mbajnë damkën që tregon se i përkasin një formacioni shoqëror, ku procesi i prodhimit sundon mbi njerëzit, e jo njeriu mbi procesin e prodhimit, — këto formula i duken ndërgjegjes së saj borgjeze si diçka që kuptohet vetvetiu, si një gjë po aq e natyrshme dhe e domosdoshme, sa edhe vetë puna prodhuese. Prandaj format paraborgjeze të organizimit shoqëror të prodhimit trajtohen prej saj aërsisht po ashtu siç trajtohen fetë e parakrishtera nga etërit e kishës.

* * *

...Një histori kritike e teknologjisë do të na tregonte, në përgjithësi, se sa vështirë është që cilado shpikje e shekullit XVIII t'i vishet këtij ose atij personi të veçantë. Por deri më sot nuk ka një vepër të tillë. Darvini është interesuar për historinë e teknologjisë natyrore, d.m.th. për formimin e organeve të bimëve dhe të kafshëve që luajnë rolin e veglave të prodhimit në jetën e tyre. A nuk meriton të studiohet me të njëjtin interes edhe historia e formimit të organeve prodhuese të njeriut shoqëror, historia e kësaj baze materiale të çdo organizate shoqërore të veçantë? Dhe a nuk do të ishte më e lehtë që të shkruhej ajo, pasi historia e njeriut, siç thotë Vikoja, ndryshon nga historia e natyrës, sepse të parën e kemi bërë ne, kurse të dytën nuk e kemi bërë ne? Teknologjia na tregon qëndrimin aktiv të njeriut kundrejt natyrës, procesin e drejtpërdrejtë të prodhimit të jetës së tij e njëkohësisht edhe të kushteve shoqërore të jetesës së tij dhe të koncepsioneve morale që burojnë prej tyre. Bile, çdo histori e fesë, që bën abstraksion nga kjo bazë materiale, nuk është kritike. Sigurisht, është shumë më lehtë të gjendet me anë të analizës bërthama tokësore e koncepsioneve të mjergullta fetare, se sa e kundërta, d.m.th. nga marrëdhëniet e jetës reale të nxirren format fetare që u përgjigjen atyre. Kjo metodë e fundit është e vetmja metodë materialiste, pra, e vetmja metodë shkencore. Të metat e materializmit abstrakt të shkencave natyrore[69], që e përjashton procesin historik, dalin menjëherë në shesh në pikëpamjet abstrakte dhe ideologjike të mbrojtësve të tij sa herë që ata guxojnë të dalin jashtë specialitetit të tyre.

* * *

...Në qoftë se lexuesi do të më përmendë Maltusin, vepra e të cilit «Essay on Population» doli më 1798, unë do t'i kujtoj se kjo vepër në formën e saj të parë nuk është veçse një plagjiat i përciptë prej shkollari, me stil deklamativ prej prifti nga veprat e Defoit, sër Xhejms Stjuartit, Taunsendit, Franklinit, Uollesit etj. dhe nuk ka asnjë tezë të vetën. Buja e madhe që bëri ky pamflet shpjegohet vetëm me interesa partie. Revolucioni francez gjeti në mbretërinë britanike mbrojtës të flaktë: «parimi i popullsisë», i cili u përpunua dalngadalë në shekullin XVIII dhe u shpall pastaj me bujë në mes të një krize të madhe sociale, si kundërhelm i sigurt për teorinë e Kondorsesë dhe të tjerëve, u prit me ngazëllim nga oligarkia angleze, e cila pa në të një mjet të mirë për çrrënjosjen e çdo aspirate për një përparim të mëtejshëm të njerëzimit. Maltusi, shumë i çuditur nga suksesi që pati, iu vu atëherë punës për ta mbushur skemën e vjetër me materiale të hartuara në mënyrë të përciptë dhe për t'i shtuar materiale të reja, të cilat, ç'është e vërteta, Maltusi nuk i zbuloi, por vetëm se i përvetësoi. Meqë ra fjala, po ju them se Maltusi, ndonëse ishte prift i kishës së lartë anglikane, kishte bërë kushtin e beqarisë të murgjve. Beqaria është një nga kushtet e *fellowship*-it [anëtarësisë] në universitetin protestant të Kembrixhit. «Të martuarve nuk u lejohet të jenë anëtarë të kolegjit. Përkundrazi, në qoftë se ndonjëri martohet, me këtë ai përjashtohet vetiu nga radhët e anëtarëve» («Reports of Cambridge University Commission», f. 172). Kjo rrethanë e bën Maltusin të dallohet nga priftërinjtë e tjerë protestantë, të cilët, pasi e hoqën qafe urdhëresën katolike të beqarisë, e bënë aq shumë të vetin urdhëresën «shtojuni dhe shumojuni» si mision të tyre të posaçëm biblik, saqë ndihmojnë kudo në një shkallë me të vërtetë të

turpshme shtimin e popullsisë dhe në të njëjtën kohë u predikojnë punëtorëve «parimin e popullsisë». Është karakteristike se parodia ekonomike e mëkatit të rrjedhshëm, molla e Adamit, «*urgent appetite*» [«dëshira e pamposhtur»], «*the checks which tend to blunt the shafts of Cupid*» [«pengesa që kanë për qëllim të topitin shigjetat e Kupidonit»], siç thotë gjithë gaz prifti Taunsend, kjo pikë delikate u monopolizua dhe vazhdon të monopolizohet edhe sot nga zotërinjtë përfaqësues të teologjisë ose, më sak, të kishës protestante. Me përjashtim të murgut venecian Ortes, autor origjinal dhe i zgjuar, shumica e predikuesve të «parimit të popullsisë» janë priftërinj protestantë. Të tillë janë Brykneri me veprën e tij «Théorie du Système animal». Lejden, 1767, ku është përmbledhur gjithë teoria e sotme e popullsisë dhe idetë e së cilës i dha konflikti i përkohshëm mbi këtë temë midis Kenesë dhe nxënësit të tij Mirabo-atit; pastaj prifti Uolles, prifti Taunsend, prifti Maltus dhe nxënësi i tij stërprift T. Çallmers, pa folur pastaj për priftërinjtë e rëndomtë kalemxhinj *in this line* [të këtij lloji]. Në fillim me ekonomi politike merreshin filozofë si Hobsi, Loku, Hjumi, afaristë dhe burra shteti si Tomas Mori, Templi, Sjuli, de Viti, Northi, Llou, Vanderlinti, Kantijoni, Franklini, dhe me anën e saj teorike janë marrë në mënyrë të veçantë, bile me shumë sukses, mjekë si Peti, Barboni, Mandevili, Keneja. Qysh në mesin e shekullit XVIII, i ndjeri z. Taker, ekonomist i dëgjuar në kohën e vet, kërkon ndjesë që është marrë me punët e Mamonës. Më vonë, dhe pikërisht me daljen e «parimit të popullsisë», u erdhi dita priftërinjve protestantë. Peti, i cili e quan popullsinë bazë të pasurisë dhe i cili, ashtu si Adam Smithi, është armik i betuar i priftërinjve, sikur ta parandiente se ata do t'i prishnin punë, thotë: «Feja lulëzon më shumë atje ku priftërinjtë e mortnojnë më shumë trupin, ashtu siç lulëzon e drejta atje ku avokatët vdesin urie». Prandaj, priftërinjve protestantë, që nuk duan të

ndjekin shembullin e apostullit Pavël dhe «ta mortnojnë trupin» duke mos u martuar, ai u këshillon, «të paktën, të mos pjellin më shumë priftërinj» *(«not to breed more Churchmen»)*, nga sa janë në gjendje të përpijnë famullitë *(benefices)* ekzistuese; d.m.th. në qoftë se në Angli dhe në Uells ka gjithsej 12 000 famulli, nuk do të ishte e udhës të pilleshin 24 000 priftërinj *(«it will not be safe to bread 24 000 ministers»)*, sepse të 12 000 priftërinjtë e mbetur pa famulli do të kërkojnë vazhdimisht mjete jetese, dhe a ka mënyrë më të lehtë për t'i gjetur këto mjete, sesa të shkosh në popull dhe t'ia mbushësh mendjen se këta 12 000, që kanë nga një famulli, marrin më qafë shpirtrat, i bëjnë të vuajnë urie dhe u tregojnë një rrugë të gabuar, e cila nuk do t'i çojë në qiell?» *(Petty.* «A Treatise of Taxes and Contributions». Londër, 1667, f. 57). Qëndrimi i Adam Smithit kundrejt priftërinjve protestantë të kohës së tij karakterizohet nga sa vijon. Në veprën «A Letter to A. Smith, Ll. D. On the Life, Death and Philosophy of his Friend David Hume». By one of the People called Christians, 4th ed., Oxford, 1784, peshkopi anglikan i Norixhit, doktor Horni, sulmon A. Smithin pse ky i fundit në një letër të hapur, drejtuar Straenit, «Balsamos mikun e vet David» (d.m.th. Hjumin) dhe i tregon publikut se si «Hjumi në shtratin e vdekjes kalonte kohën duke lexuar Lukianin dhe duke luajtur uist» dhe pse ai pati bile paturpësinë të shkruante: «Unë e kam quajtur gjithmonë Hjumin, si me gjallje të tij, ashtu edhe pas vdekjes, si njeri që i është afruar idealit të përsosur të një njeriu të urtë dhe të virtytshëm aq sa e lejon dobësia e natyrës njerëzore». Peshkopi thërret i zemëruar: «A është mirë që ju, i nderuar zotëri, të na i paraqisni si diçka që ka arritur kulmin e urtësisë dhe të virtytit karakterin dhe mënyrën e jetesës të një njeriu, i cili ushqente një antipati të thellë për çdo gjë që quhet fe dhe vinte të gjitha forcat e veta për ta fshirë, me aq sa kishte në dorë, nga kujtesa e njeriut edhe vetë fjalën fe?» (po

aty, f. 8). «Por mos e humbni kurajën, o miq të së vërtetës, ateizmi nuk i ka ditët të gjata» (po aty, f. 17). Adam Smithi arrin në një «ligësi aq të përbindshme *(«the atrocious wickedness»)*, saqë propagandon ateizmin në gjithë vendin» (pikërisht me anën e «Theory of moral sentiments» të tij) «...Ne i dimë dredhitë tuaja, zoti doktor! Ju bukur e menduat, vetëm se këtë radhë i bëtë hesapet pa hanxhinë. Duke marrë si shembull David Hjumin, ju donit të na mbushnit mendjen se ateizmi është i vetmi ilaç *(«cordial»)* kundër dekurajimit dhe i vetmi kundërhelm për të luftuar frikën e vdekjes... Qeshni atëherë me gërmadhat e Babilonisë dhe përshëndetni faraonin, katilin e regjur!» (po aty, f. 21, 22). Një nga dëgjuesit ortodoksë të leksioneve të A. Smithit shkruan pas vdekjes së këtij të fundit: «Miqësia e Smithit me Hjumin... e pengoi që të ishte i krishterë... Për çdo gjë ai kishte besim të verbër te Hjumi. Sikur Hjumi t'i kishte thënë se hëna është një rrotë e gjelbër kaçkavalli, ai do ta kishte besuar. Për këtë arsye ai i besonte atij se nuk ka as zot as mrekulli... Nga parimet e tij politike ai ishte afër republikanizmit» («The bee». By *James Anderson.* 18 vols. Edinburgh, 1791-1793, vol. III, p. 166, 165). Prifti T. Çallmers dyshon që A. Smithi ta ketë shpikur kategorinë e «punëtorëve joprodhues» vetëm për inat dhe posaçërisht për priftërinjtë protestantë, me gjithë punën e tyre të bekuar në vreshtin e perëndisë.

F. ENGELS

LITERATURA E EMIGRACIONIT

[Nga artikulli i dytë]

...Blankistët tanë kanë një tipar të përbashkët me bakunistët: ata duan të jenë përfaqësuesit e rrymës që shkon më larg, të rrymës më ekstremiste. Dhe prandaj, meqë ra fjala, megjithëqë ndjekin qëllime krejt të kundërta, shumë herë ata u afrohen bakunistëve nga mjetet që përdorin. Pra, është fjala për të qenë më radikalë nga të gjithë në lidhje me ateizmin. Në ditët tona, për fat të mirë, nuk është ndonjë gjë e madhe të jesh ateist. Ateizmi në të vërtetë është një gjë që vetëkuptohet në partitë punëtore evropiane, ndonëse në disa vende ai shpesh ka karakterin e ateizmit, të atij bakunisti spanjoll, i cili deklaroi: të besosh zotin është në kundërshtim me çdo socializëm, por të besosh shën Mërinë virgjër është krejt ndryshe, asaj, natyrisht, duhet t'i besojë çdo socialist i ndershëm. Për shumicën dërrmuese të punëtorëve socialdemokratë gjermanë* mund të thuhet bile se ateizmi është bërë për ta një etapë e kaluar; ky cilësim thjesht negativ nuk u përshtatet më atyre, sepse mosbesimi i tyre te zoti nuk është më teorik, por praktik, ata *e kanë flakur fare zotin*, ata jetojnë dhe mendojnë në botën reale dhe prandaj janë materialistë. Po kështu është edhe në Francë.

* Në «Volksstaat», ku ka qenë botuar ky artikull, është shkruar «Për punëtorët socialdemokratë gjermanë». *Red.*

Dhe në mos qoftë kështu, atëherë a ka gjë më të lehtë se të kujdesesh për përhapjen në masë midis punëtorëve të letërsisë së mrekullueshme materialiste franceze të shekullit të kaluar, të asaj letërsie, e cila edhe sot e kësaj dite, si nga forma ashtu edhe nga përmbajtja, është realizimi më i lartë i mendjes franceze dhe e cila, po të marrim parasysh nivelin e atëhershëm të shkencës, nga përmbajtja edhe sot e kësaj dite qëndron jashtëzakonisht lart, ndërsa nga forma vazhdon të jetë një model i paarritshëm? Por blankistëve tanë nuk u pëlqen kjo, dhe që të provojnë se ata janë më radikalët, zotin, si më 1793, ata e heqin me dekret:

> «Komuna le ta çlirojë përgjithmonë njerëzimin nga kjo fantazmë e fatkeqësive të kaluara» (nga zoti), «nga ky shkak» (zoti që nuk ekziston qenka shkak!) «i fatkeqësive të tij të sotme. — Në Komunë s'ka vend për priftërinjtë; çdo predikim fetar, çdo organizatë fetare duhet të ndalohet».

Dhe këtë kërkesë — për t'i bërë njerëzit ateistë *par ordre du mufti** — e kanë nënshkruar dy anëtarë të Komunës, të cilët me siguri kanë pasur mjaft raste për t'u bindur se, së pari, mund të shkruash sa të duash urdhra në letër, pa siguruar aspak në këtë mënyrë zbatimin e tyre praktik, dhe së dyti, se ndjekjet janë mjeti më i mirë për të rrënjosur bindjet e padëshirueshme! Një gjë është e sigurt: i vetmi shërbim që sot mund t'i bëhet ende zotit është të shpallet ateizmi simbol i detyrueshëm besimi dhe t'ia kalohet «kulturkampfit»[70] të Bismarkut, ligjeve të tij mbi kishën, duke e *ndaluar fare* fenë...

* — me urdhrin e myftiut, d.m.th. me urdhër nga lart. *Red.*

K. MARKS

KRITIKA E PROGRAMIT TË GOTËS

[*F r a g m e n t*]

«Liri e ndërgjegjes»! Në qoftë se tani, në kohën e «kulturkampfit», kanë dashur t'u kujtojnë liberalëve parullat e tyre të vjetra, kjo gjë mund të bëhej vetëm në këtë formë: Secili duhet të ketë mundësi të plotësojë nevojat e veta fetare, si dhe ato trupore, dhe policia nuk duhet të fusë hundët në këtë mes. Por partia punëtore duhej të përfitonte nga ky rast dhe të shprehte bindjen e vet se «liria» borgjeze «e ndërgjegjes» nuk është asgjë më tepër veçse tolerim kundrejt të gjitha llojeve të *lirisë së ndërgjegjes fetare,* kurse partia punëtore, përkundrazi, përpiqet ta çlirojë ndërgjegjen nga opiumi i fesë. Mirëpo, ndër ne nuk duan ta kapërcejnë nivelin «borgjez»[71].

F. ENGELS

ANTI-DYRING

[*F r a g m e n t e*][72]

...Krishterimi njihte vetëm *një* barazi për gjithë njerëzit, dhe pikërisht — barazinë e mëkatit të parë, gjë që përputhej plotësisht me karakterin e tij si fe e skllevërve dhe te të shtypurve. Krahas me këtë, ai njihte të shumtën edhe barazinë e të zgjedhurve, e cila, megjithatë, u theksua vetëm në periudhën më fillestare të krishterimit. Gjurmët e bashkësisë së pasurisë, të cilat i shohim gjithashtu në fazën fillestare të fesë së re, shpjegohen më tepër me solidarësinë që ekzistonte midis të persekutuarve sesa me ide të vërteta barazie. Shumë shpejt kundërtia që u vendos midis priftit dhe laikut i dha fund edhe këtij embrioni të barazisë së krishterë. — Invadimi i Evropës Perëndimore nga gjermanët zhduku për shekuj çdo ide barazie, duke krijuar dalngadalë një hierarki shoqërore dhe politike të një tipi aq të ndërlikuar, sa nuk ishte parë deri atëherë. Por ai tërhoqi njëkohësisht në lëvizjen e historisë Evropën Perëndimore dhe Qendrore dhe krijoi këtu për të parën herë një zonë kulturore kompakte, ku për të parën herë lindi sistemi i shteteve kryesisht kombëtare, të cilat ndikonin njëri mbi tjetrin dhe mbanin nën presionin e frikës njëri-tjetrin. Në këtë mënyrë u përgatit i vetmi terren, mbi të cilin u bë e mundshme të flitej më vonë për barazi njerëzore, për të drejta të njeriut...

* * *

...Thelbi i sovranitetit të individit, sipas z. Dyring, është se

> «individi i nënshtrohet *në mënyrë absolute detyrimit* shtetëror», por ky detyrim mund të justifikohet vetëm përderisa ai «i shërben me të vërtetë drejtësisë natyrore». Për këtë qëllim do të ekzistojnë «legjislacioni dhe pushteti gjyqësor», të cilët, megjithatë, «duhet të mbeten në duart e gjithë kolektivit», pastaj — një aleancë mbrojtëse, që shfaqet në «shërbimin e përbashkët në radhët e ushtrisë apo në përbërjen e ndonjë organi ekzekutiv, që ka për detyrë të garantojë sigurimin e brendshëm», —

pra, do të ketë edhe ushtri edhe polici edhe xhandarë. Z. Dyring është treguar më se një herë prusian trim; kurse këtu ai ka provuar se i ngjet atij prusiani model, i cili, sipas fjalëve të të ndjerit ministër fon Rohov, «e mban në gji xhandarin e vet». Por kjo xhandarmëri e së ardhmes nuk do të jetë aq e rrezikshme sa bashibozukët e sotëm. Çfarëdo që ajo t'i bëjë individit sovran, ky i fundit do të ketë gjithmonë *një ngushëllim:*

> «Drejtësia apo padrejtësia që, sipas rrethanave, i bëhet nga ana e shoqërisë së lirë, nuk mund të jetë kurrë më e keqe se ajo që do të sillte me vete *gjendja natyrore!*»

Dhe, pasi na bën të përplasemi edhe një herë me të drejtën e autorit, z. Dyring na siguron se në botën e tij të re

> do të ketë, «kuptohet vetvetiu, një avokaturë krejt të lirë dhe të hapur për të gjithë».

«Shoqëria e lirë e shpikur tani» po bëhet gjithnjë më e larme. Arkitektë, punëtorë që punojnë me karrocë dore, letrarë, xhandarë, e tani ja edhe avokatë! Kjo «mbretëri e shëndoshë dhe kritike e mendimit» u përngjet pikë për pikë mbretërive të ndryshme qiellore të feve të ndryshme, ku besimtari gjen kurdoherë përsëri në një trajtë të transformuar të gjitha ato gjëra që i zbukuronin jetën në tokë. Por z. Dyring është nga ai shtet, në të cilin «kushdo mund të shpëtojë si të mundë». E ç'të duam më tepër?

Se çfarë duam ne, kjo në këtë rast s'ka rëndësi. Këtu është fjala se çfarë do z. Dyring. Dhe ndryshimi midis tij e Frederikut II është se në shtetin dyringian të së ardhmes nuk mund të shpëtojë aspak kushdo si të mundë. Në kushtetutën e këtij shteti të së ardhmes thuhet:

> «Në shoqërinë e lirë nuk duhet të ketë asnjëfarë kulti, *sepse* secili nga anëtarët e saj qëndron më lart se ideja primitive dhe fëmijnore se prapa natyrës apo përmbi të banojnë krijesa, mbi të cilat mund të ndikohet me flijime apo me lutje». «Prandaj një sistem socialitar i kuptuar drejt *duhet... të zhdukë* çdo gjë që ka të bëjë me magjitë klerikale dhe, si rrjedhim, të gjitha elementet esenciale të kultit».

Feja ndalohet.

Mirëpo dihet se çdo fe s'është gjë tjetër veçse pasqyrimi fantastik në kokat e njerëzve i forcave të jashtme që sundojnë mbi ta në jetën e tyre të përditshme, — pasqyrim, në të cilin forcat tokësore marrin formën e forcave jotokësore. Në fillim të historisë objekt të këtij pasqyrimi janë para së gjithash forcat e natyrës, të cilat gjatë evolucionit të mëtejshëm marrin ndër popujt e ndryshëm lloj-lloj personifikimesh të ndryshme. Mitologjia e krahasuar ka mundur ta ndjekë këtë proces primitiv — së paku ndër popujt indo-evropianë — deri

në shfaqjet e tij të para në Vedat indiane, dhe ta studiojë imtësisht zhvillimin e tij të mëtejshëm ndër indutë, persianët, grekët, romakët, gjermanët dhe, sa lejojnë materialet, edhe ndër keltët, lituanët dhe sllavët. Por fill pas kësaj, krahas forcave të natyrës, dalin edhe forcat shoqërore, — forca që qëndrojnë përballë njeriut dhe që janë po aq të huaja dhe në fillim po aq të pashpjegueshme për të, sa edhe forcat e natyrës, dhe si këto të fundit sundojnë mbi të me të njëjtën domosdoshmëri natyrore aparente. Figurat fantastike, në të cilat shpreheshin në fillim vetëm forcat misterioze të natyrës, marrin tani edhe atribute shoqërore dhe bëhen përfaqësuese të forcave historike*. Në etapën e mëtejshme të zhvillimit tërë atributet natyrore dhe shoqërore të perëndive të shumta i kalojnë *një* zoti *të vetëm* të plotfuqishëm, i cili, nga ana e vet, s'është gjë tjetër veçse pasqyrimi i njeriut abstrakt. Kështu lindi monoteizmi, i cili historikisht ka qenë produkti i fundit i filozofisë vulgare greke të epokës më të vonshme dhe gjeti mishërimin e vet të gatshëm në zotin vetëm e vetëm kombëtar Jahve të çifutëve. Në këtë formë të volitshme për t'u përdorur dhe që i përshtatet çdo gjëje feja mund të vazhdojë të ekzistojë si një formë e drejtpërdrejtë, d.m.th. emocionale e qëndrimit të njerëzve ndaj forcave të huaja, natyrore dhe shoqërore, që i sundojnë, sa kohë që njerëzit gjenden në fakt nën push-

* Ky karakter i dyfishtë, që morën më vonë figurat e perëndive, qe shkaku i ngatërresës që lindi më vonë në mitologjitë, — shkak që s'e vuri re mitologjia e krahasuar, e cila vazhdon të shohë në mënyrë të njëanshme në perënditë vetëm pasqyrimin e forcave të natyrës. Kështu, ndër disa tribu gjermane perëndia e luftës quhet në skandinavishten e vjetër Tir, në gjermanishten e vjetër Cio, që i përgjigjet, rrjedhimisht, Zeusit grek, Jupiterit latin («Jupiter» në vend të «Diu-Piter»); ndër të tjerë ai quhet Er, Eor, duke iu përgjigjur kështu Aresit grek dhe Marsit latin.

tetin e këtyre forcave. Por ne kemi parë tashmë herë pas here se në shoqërinë borgjeze të sotme mbi njerëzit sundojnë, si një forcë e huaj, marrëdhëniet ekonomike që ata vetë i kanë krijuar, mjetet e prodhimit që ata vetë i kanë prodhuar. Baza e vërtetë e pasqyrimit fetar të realitetit vazhdon pra të ekzistojë, dhe bashkë me këtë bazë vazhdon të ekzistojë edhe pasqyrimi i saj në fe. Edhe në qoftë se ekonomia politike borgjeze na jep njëfarë shpjegimi të lidhjes shkakësore të këtij sundimi të forcave të huaja, kjo nuk e ndryshon aspak çështjen. Ekonomia politike borgjeze nuk është në gjendje as t'i ndalojë krizat në përgjithësi as ta ruajë kapitalistin e veçantë nga humbjet, nga borxhet pa rrugëdalje dhe nga falimentot, as ta shpëtojë punëtorin nga papunësia dhe nga mjerimi. Edhe sot ende përdoret fjala e urtë: njeriu mendon, zoti (d.m.th. sundimi i forcave të mënyrës kapitaliste të prodhimit, të huaja për njeriun) vendos. Vetëm njohja, sado që kjo njohje të shkojë më larg dhe më thellë se njohja e ekonomisë politike borgjeze, nuk mjafton për t'i vënë forcat shoqërore nën sundimin e shoqërisë. Për këtë duhet para së gjithash një *veprim* shoqëror. Dhe kur të kryhet ky veprim, kur shoqëria, pasi të marrë në zotërim të gjitha mjetet e prodhimit dhe t'i drejtojë ato me plan, të çlirojë në këtë mënyrë veten dhe të gjithë anëtarët e vet nga skllavëria, në të cilën i mbajnë sot mjetet e prodhimit që ata vetë i kanë prodhuar, por të cilat qëndrojnë përballë tyre si një forcë e jashtme e pamposhtur, pra, kur njeriu jo vetëm do të mendojë, por edhe do të vendosë, — vetëm atëherë do të zhduket forca e fundit e huaj, që vazhdon edhe sot e kësaj dite të pasqyrohet në fenë, e bashkë me këtë do të zhduket edhe vetë pasqyrimi fetar, për arsyen e thjeshtë se atëherë nuk do të ketë më ç'të pasqyrojë.

Por z. Dyring nuk mund të presë derisa feja të vdesë nga vdekja e saj e natyrshme. Ai vepron në një mënyrë më rrënjësore. Ai është më Bismark se Bis-

marku: ai dekreton ligje të majit[73] edhe më të rrepta jo vetëm kundër katolicizmit, por edhe kundër çdo feje në përgjithësi; ai i ndërsen xhandarët e vet të së ardhmes kundër fesë dhe e ndihmon atë kështu të dalë si martire dhe ta zgjasë në këtë mënyrë ekzistencën e saj. Ngado që t'i hedhësh sytë, nuk gjen veçse socializmin specifik prusian...

Barazia-drejtësia. — Ideja se barazia është shprehja e drejtësisë, parimi i një rendi politik dhe shoqëror të përsosur, ka lindur krejt historikisht. Në komunat primitive nuk kishte barazi, ose ajo ekzistonte vetëm në përpjesëtime shumë të kufizuara për anëtarin e një komune të veçantë, anëtar që gëzonte të gjitha të drejtat, dhe kombinohej me ekzistencën e skllavërisë. Të njëjtën gjë shohim edhe në demokracinë e lashtë. Barazia e gjithë njerëzve — e grekëve, e romakëve dhe e barbarëve, e të lirëve dhe e skllevërve, e vendasve dhe e të huajve, e qytetarëve të shtetit dhe e atyre që gëzonin vetëm përkrahjen e tij, etj. — i dukej njeriut të lashtë jo vetëm absurde, por edhe kriminale, dhe ka qenë një gjë e logjikshme që shfaqjet e para të saj në kohën e krishterimit të kenë qenë objekt ndjekjesh. — Në krishterimin u shpreh për herë të parë *barazia negative përpara zotit e të gjithë njerëzve si mëkatarë* dhe në një kuptim më të ngushtë barazia e këtyre dhe e atyre bijve të zotit, mëkatet e të cilëve u lanë me mëshirën dhe me gjakun e Krishtit. Si koncepsioni i parë, ashtu edhe i dyti, buronin nga roli i krishterimit si fe e skllevërve, e të dëbuarve, e të përbuzurve, e të ndjekurve dhe e të shtypurve. Me fitoren e krishterimit ky faktor kaloi në plan të fundit; më i rëndësishëm u bë para së gjithash kontrasti midis besnikëve dhe paganëve, ortodoksëve dhe heretikëve. — Forcimi i qyteteve dhe, njëkohësisht, i elementeve pak a shumë të zhvilluara si të borgjezisë, ashtu edhe të proletariatit, duhej patjetër të zgjonte përsëri dalngadalë kërkesën e barazisë si kusht të ekzistencës së borgjezisë, dhe me këtë ishte i lidhur fakti që proletarët nga barazia politike filluan të nxirrnin barazinë shoqërore. Për të parën herë kjo u shpreh në mënyrë të theksuar — natyrisht, në formë fetare — në Luftën fshatare. — Ana borgjeze e kërkesës së barazisë u formulua për herë të parë në mënyrë të prerë, — por ende në formën e një kërkese për gjithë njerëzimin, — nga Rusoi. Siç ka ndodhur me të gjitha kërkesat e borgjezisë, edhe në këtë rast proletariati e ndjek borgjezinë si një hije fatale dhe nxjerr përfundimet e tij (Babëfi). Kjo lidhje midis barazisë borgjeze dhe përfundimeve proletare duhet të zhvillohet më me hollësi...

* * *

...Vetë pasqyrimi i saktë i *natyrës* është punë e vështirë, produkt i historisë së gjatë të përvojës. Forcat e natyrës i duken njeriut primitiv si diçka e huaj, misterioze, shtypëse. Në një shkallë të caktuar, nëpër të cilën kalojnë *gjithë* popujt e kulturuar, ai mësohet me to duke i mishëruar. Pikërisht kjo tendencë për të mishëruar ka krijuar kudo perënditë, dhe *consensus gentium**, të cilit i referohet prova e qenies së zotit, provon pikërisht vetëm karakterin e përgjithshëm të kësaj tendence për të bërë mishërime si shkallë kalimi e domosdoshme, — dhe si pasojë, edhe karakterin e përgjithshëm të fesë. Vetëm njohja e vërtetë e forcave të natyrës dëbon perënditë nga njëra fushë pas tjetrës (Seki dhe sistemi diellor i tij)**. Sot ky proces ka shkuar aq përpara, saqë teorikisht ai mund të quhet i kryer.

---

* — pëlqimi i gjithë popujve. *Red.*

** — Krahaso «Dialektikën e natyrës», bot. shqip, 1973, f. 230. *Red.*

Në sferën e fenomeneve *shoqërore* pasqyrimi është një punë edhe më e vështirë. Shoqëria përcaktohet nga marrëdhëniet ekonomike, nga prodhimi dhe nga këmbimi, krahas me premisat historike...

F. ENGELS

DIALEKTIKA E NATYRËS

[Disa kapituj dhe fragmente]

HYRJE

Studimi i sotëm i natyrës — i vetmi që na ka dhënë një zhvillim shkencor, sistematik e të gjithanshëm, ndryshe nga supozimet gjeniale të të vjetërve në fushën e filozofisë së natyrës dhe nga zbulimet mjaft të rëndësishme, por sporadike të arabëve, të cilat në pjesën e tyre më të madhe janë zhdukur pa dhënë rezultat, — studimi i sotëm i natyrës, ashtu si gjithë historia e re, zë fill me atë epokë të madhe, të cilën ne, gjermanët, për shkak të fatkeqësisë kombëtare që na ndodhi atëherë, e quajmë Reformë, francezët — *Renesans* e italianët — *Cinquecento** dhe brendinë e së cilës nuk e jep plotësisht asnjë nga këta emra. Kjo është epoka që fillon nga gjysma e dytë e shekullit XV. Pushteti mbretëror, duke u mbështetur në banorët e qyteteve, e shkallmoi forcën e fisnikërisë feudale dhe krijoi monarki të mëdha, të bazuara në thelb në kombësinë, monarki në të cilat u zhvilluan kombet e sotme të Evropës dhe shoqëria e sotme borgjeze; dhe ndërsa banorët e qyteteve dhe fisnikëria vazhdonin të grindeshin midis tyre, Lufta fshatare në Gjermani paralajmëroi në

---

* — fjalë për fjalë: vjetët pesëqind — domethënë shekulli XVI. *Red.*

mënyrë profetike betejat e ardhshme klasore, sepse gjatë kësaj lufte dolën në skenë jo vetëm fshatarët kryengritës, — kjo nuk ishte më një gjë e re, — por prapa tyre u dukën paraardhësit e proletariatit të sotëm me flamurin e kuq në dorë dhe me kërkesën e bashkësisë së pasurisë në gojë. Në doreshkrimet që shpëtuan me rënien e Bizantit, në statujat antike të nxjerra nga gërmadhat e Romës, përpara Perëndimit të habitur doli një botë e re — lashtësia greke; përpara figurave të saj plot dritë u zhdukën fantazmat e mesjetës; në Itali filloi një lulëzim i paparë i artit, që ishte si një refleks i lashtësisë klasike dhe që nuk u arrit kurrë më. Në Itali, në Francë dhe në Gjermani lindi një letërsi e re, e para letërsi moderne. Fill pas kësaj Anglia dhe Spanja kaluan epokën e vet letrare klasike. Kufijtë e *«orbis terrarum»** të vjetër u prishën; vetëm tani u zbulua me të vërtetë Toka dhe u hodhën bazat e tregtisë së mëvonshme botërore dhe të kalimit nga zejet në manufakturën, e cila, nga ana e vet, shërbeu si pikënisje për industrinë e madhe moderne. Diktatura shpirtërore e kishës u shkallmua, shumica e popujve gjermanë e flakën haptazi atë dhe u kthyen në protestantizëm, ndërsa ndër popujt romanë filloi të rrënjosej gjithnjë më tepër mendimi i lirë dhe optimist, i marrë prej arabëve dhe i ushqyer nga filozofia greke e porsazbuluar, mendim që përgatiti materializmin e shekullit XVIII.

Kjo ishte kthesa më e madhe përparimtare nga të gjitha ato që kishte parë njerëzimi deri atëherë, ishte një epokë që kishte nevojë për titanë dhe që lindi titanë nga forca e mendimit, pasioni dhe karakteri, nga shumanshmëria dhe dituria e tyre. Njerëzit që themeluan sundimin e sotëm të borgjezisë ishin ç'të doni, por nuk ishin aspak njerëz me pikëpamje të ngushta borgjeze. Përkundrazi, ata ishin pak a shumë të pushtuar

* *«Orbis terrarum»* — fjalë për fjalë: rrethi i tokave; kështu e quanin romakët e vjetër botën, Tokën. *Red.*

nga fryma e kërkuesve të guximshëm të aventurave, karakteristike për atë kohë. Atëherë nuk kishte gati asnjë njeri të madh që të mos kishte bërë udhëtime të largëta, të mos fliste katër ose pesë gjuhë, të mos shkëlqente në disa fusha të krijimtarisë. Leonardo da Vinçi nuk ishte vetëm një piktor i madh, por edhe një matematikan, mekanik dhe inxhinier i madh, që bëri zbulime të rëndësishme në degët më të ndryshme të fizikës. Albreht Dyreri ishte piktor, gdhendës, skulptor, arkitekt dhe, përveç kësaj, ka shpikur një sistem fortifikimesh që përmban disa ide, të cilat shumë më vonë u shfrytëzuan përsëri nga Montalamberi dhe nga teoria moderne gjermane e fortifikimeve. Makiaveli ishte burrë shteti, historian, poet dhe, përveç kësaj, i pari shkrimtar ushtarak i kohës së re që vlen të përmendet. Luteri spastroi shtallat e Augiasit jo vetëm të kishës, por edhe të gjuhës gjermane, krijoi prozën moderne gjermane dhe hartoi tekstin dhe melodinë e asaj koraleje plot besim në fitoren, e cila u bë «Marsejeza» e shekullit XVI. Heronjtë e asaj kohe nuk ishin bërë ende skllevër të ndarjes së punës, ndikimi i së cilës, siç vëmë re shpeshherë, i kufizon dhe i bën të njëanshëm pasardhësit e tyre. Por veçanërisht karakteristike për ta është se pothuajse të gjithë janë të lidhur ngushtë me interesat e kohës së vet, marrin pjesë gjallërisht në luftën praktike, marrin anën e kësaj ose asaj partie dhe luftojnë kush me fjalë e me penë, kush me shpatë e kush edhe me njërën edhe me tjetrën së bashku. Këtu e ka burimin ajo përsosuri dhe forcë karakteri që i bën ata njerëz të vërtetë. Dijetarët e shkëputur nga jeta praktike atëherë ishin një përjashtim; këta ishin ose njerëz të dorës së dytë e të tretë ose filistej të matur që nuk donin të digjnin gishtërinjtë.

Edhe studimi i natyrës atëherë bëhej në kushtet e një revolucioni të përgjithshëm dhe ishte vetë fund e krye revolucionar, sepse duhej ende të luftonte për të fituar të drejtën e ekzistencës. Bashkë me italianët e

mëdhenj, me të cilët zë fill historia e filozofisë së re, ai ka dhënë martirët e vet për zjarret dhe për burgjet e inkuizicionit. Dhe është karakteristike se protestantët ua kaluan katolikëve në persekutimin e studimit të lirë të natyrës. Kalvini e dogji Servetin, kur ky ishte gati të zbulonte sistemin e qarkullimit të gjakut, madje dha urdhër ta piqnin të gjallë dy orë rresht; inkuizicioni u mjaftua të paktën vetëm ta digjte Xhordano Brunon.

Akti revolucionar, me të cilin studimi i natyrës shpalli pavarësinë e vet, duke përsëritur, si të thuash, aktin e Luterit që dogji bullën* e papës, qe botimi i veprës së pavdekshme[74], me të cilën Koperniku, — ndonëse me druajtje dhe, si të thuash, vetëm në shtratin e vdekjes — i hodhi një sfidë autoritetit të kishës në lidhje me çështjet e natyrës. Me këtë fillon historia e çlirimit të shkencave të natyrës nga teologjia, megjithëse zgjidhja e disa pretendimeve reciproke midis tyre është zgjatur deri në ditët tona dhe në disa kokë nuk ka marrë fund as sot. Por që atëherë shkoi përpara me hapa viganë edhe zhvillimi i shkencave, i cili forcohej, nëse mund të shprehemi kështu, në përpjesëtim me katrorin e largësisë (në kohë) nga pikënisja e vet. Dukej sikur i duhej provuar botës se këtej e tutje për produktin më të lartë të materies organike, për frymën e njeriut, është në fuqi një ligj i lëvizjes, i kundërt me ligjin e lëvizjes së materies inorganike.

Puna kryesore në periudhën e parë të zhvillimit të shkencave të natyrës, që sapo kishte filluar, ishte përvetësimi i materialit ekzistues. Në shumicën e fushave të diturisë duhej filluar që nga alfa. Nga lashtësia ishin trashëguar Euklidi[75] dhe sistemi diellor i Ptolemeut[76]; nga arabët — sistemi dhjetor i njehsimit, elementet e algjebrës, shifrat e sotme dhe alkimia[77]; mesjeta e krishterë nuk la asgjë. Në këto kushte ishte e pashmang-

* bulla (lat.) — urdhëresë e papës së Romës për çështje fetare. *Red. Përkth.*

shme që vendin e parë ta zinin shkencat më elementare të natyrës — mekanika e trupave tokësorë dhe qiellorë dhe, krahas me të e në shërbim të saj, zbulimi dhe perfeksionimi i metodave matematike. Në këtë fushë u bë një punë e madhe. Në fund të kësaj periudhe, që shquhet me emrat e Njutonit dhe të Lineut, shohim se këto degë të shkencës arritën njëfarë përsosurie. Në vija të përgjithshme u përcaktuan metodat matematike më të rëndësishme: gjeometria analitike — kryesisht nga Dekarti, logaritmet — nga Neperi, njehsimi diferencial dhe integral — nga Lajbnici e, ndoshta, nga Njutoni. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për mekanikën e trupave të ngurtë, ligjet kryesore të së cilës u sqaruan një herë e përgjithmonë. Më në fund, në astronominë e sistemit diellor Kepleri zbuloi ligjet e lëvizjes së planetëve dhe Njutoni i formuloi nga pikëpamja e ligjeve të përgjithshme të lëvizjes së materies. Degët e tjera të shkencave të natyrës ishin ende larg bile edhe nga një përsosuri e tillë paraprake. Mekanika e trupave të lëngët dhe të gaztë u përpunua në një shkallë më të madhe vetëm nga fundi i kësaj periudhe*. Fizika, në kuptimin e vërtetë të fjalës, ende nuk i kishte kaluar shkallët më të para, fillestare të zhvillimit, me përjashtim të optikës, e cila kishte arritur suksese të jashtëzakonshme në saje të nevojave praktike të astronomisë. Kimia porsa ishte çliruar nga alkimia me anën e teorisë së flogjistonit[78]. Gjeologjia nuk kishte dalë ende nga faza embrionale e mineralogjisë dhe prandaj paleontologjia ende nuk mund të ekzistonte. Më në fund, në fushën e biologjisë vazhdonin të merreshin kryesisht me grumbullimin e me sistemimin fillestar të një materiali shumë të madh, si botanik e zoologjik, ashtu edhe anatomik e thjesht fiziologjik. Për krahasimin e formave të jetës midis tyre, për studimin e për-

* Shënim anës dorëshkrimit: «Torriçeli në lidhje me sistemin e përrenjve alpinë». *Red.*

hapjes së tyre gjeografike, të kushteve të tyre klimatologjike dhe të kushteve të tjera të ekzistencës ende nuk mund të flitej pothuajse fare. Këtu vetëm botanika dhe zoologjia kishin arritur njëfarë përsosurie në saje të Lineut.

Por ajo që karakterizon në mënyrë të veçantë periudhën që po shqyrtojmë, është përpunimi i një botëkuptimi të përgjithshëm origjinal, që mbështetet kryesisht në idenë se *natyra është absolutisht e pandryshueshme*. Sipas kësaj pikëpamjeje, natyra, sido që ajo të ketë lindur, derisa lindi, mbetej gjithnjë e pandryshuar, sa kohë që ekziston. Planetët dhe satelitët e tyre, pasi u vunë një herë në lëvizje nga «shtytja e parë» misterioze, vazhdonin të rrotulloheshin sipas elipsesh që u janë caktuar përgjithnjë ose, sidoqoftë, deri në mbarimin e të gjitha sendeve. Yjtë qëndronin gjithnjë të palëvizshëm në vendet e veta duke e mbajtur njëri-tjetrin në këtë gjendje me anën e «gravitacionit universal». Toka mbetej prej amshimit ose që nga dita e krijimit të vet (sipas kësaj ose asaj pikëpamjeje) gjithnjë e njëllojtë. «Pesë kontinentet e botës», që kemi sot, kanë qenë gjithnjë, kanë pasur gjithnjë të njëjtat male, lugina e lumenj, të njëjtën klimë, të njëjtën florë e faunë, po të mos flasim për gjërat që ka ndryshuar ose ka lëvizur nga vendi dora e njeriut. Llojet e bimëve dhe të kafshëve ishin caktuar një herë e përgjithmonë që kur lindën, nga i njëjti lloj lindte gjithnjë i njëjti lloj dhe Lineu bënte me të vërtetë një lëshim të madh kur pranonte se në disa raste me anën e kryqëzimit edhe mund të lindin lloje të reja. Në kundërshtim me historinë e njerëzimit, që zhvillohet në kohë, për historinë e natyrës thuhej se ajo zhvillohet vetëm në hapësirë. Çdo ndryshim, çdo zhvillim i natyrës mohohej. Shkencat e natyrës, që ishin aq revolucionare në fillim, u ndodhën menjëherë përpara një natyre krejt konservatore, ku çdo gjë edhe tani vazhdon të mbetet ashtu siç ka qenë në fillim, dhe ku çdo gjë duhej të mbetej

deri në mbarim të botës ose për jetë të jetëve ashtu siç ka qenë në fillim.

Sa lart qëndronin shkencat e natyrës të gjysmës së parë të shekullit XVIII në krahasim me lashtësinë greke përsa i përket gjerësisë së njohurive të tyre, madje edhe sistemimit të materialit, aq poshtë qëndronin ato në krahasim me të përsa i përket përvetësimit ideologjik të këtij materiali dhe kuptimit të përgjithshëm të natyrës. Për filozofët grekë bota ka qenë në thelb diçka që kishte lindur nga kaosi, diçka që ishte zhvilluar, diçka që ishte bërë. Për natyralistët e periudhës që po shqyrtojmë ajo ka qenë diçka e ngurtë, e pandryshueshme dhe për shumicën diçka e krijuar menjëherë. Shkenca ishte ende e zhytur thellë në teologji. Ajo kërkon dhe gjen kudo si shkak të fundit një shtytje nga jashtë, që nuk mund të shpjegohet me vetë natyrën. Edhe në qoftë se tërheqja, të cilën Njutoni e quajti në mënyrë emfatike gravitacion universal, merret si një veti esenciale e materies, atëherë ku e ka burimin forca tangenciale e pakuptueshme, e cila është e vetmja që vë për herë të parë në lëvizje planetët në orbitat e tyre? Si lindën llojet e panumërta të bimëve e të kafshëve? Dhe si lindi, në mënyrë të veçantë, njeriu, për të cilin dihej sidoqoftë me siguri se ai nuk ka ekzistuar prej jetë të jetëve? Të gjitha këtyre pyetjeve shkencat e natyrës shumë shpesh u përgjigjeshin vetëm duke shpallur përgjegjës për të gjitha këto krijuesin e të gjitha sendeve. Në fillim të periudhës që po shqyrtojmë Koperniku shkroi letrën e vet, në të cilën i dha dërmën teologjisë; Njutoni e mbyll këtë periudhë me postulatin e shtytjes së parë hyjnore. Mendimi më i lartë përgjithësues, deri në të cilin u ngritën shkencat e natyrës të kësaj periudhe, ka qenë mendimi se në natyrë çdo gjë ka një qëllim të caktuar, ka qenë teleologjia banale e Volfit, sipas së cilës macet u krijuan për të ngrënë minjtë, minjtë për t'u ngrënë nga macet dhe e gjithë natyra për të vërtetuar urtësinë e krijuesit. Duhet pranuar se një

meritë shumë e madhe e filozofisë së atëhershme ka qenë se ajo, me gjithë dijet e kufizuara të shkencave të natyrës të asaj kohe, nuk e humbi toruan, se ajo, duke filluar nga Spinoza e deri te materialistët e mëdhenj francezë, është përpjekur me këmbëngulje ta shpjegonte botën duke u nisur nga vetë bota, duke ua lënë shkencave të natyrës të së ardhmes ta justifikonin këtë në mënyrë të hollësishme.

Unë përfshij në këtë periudhë edhe materialistët e shekullit XVIII, sepse ata nuk kishin tjetër material të shkencave të natyrës përveç atij që përshkruam më lart. Vepra e Kantit, që bëri epokë, mbeti për ta një mister, ndërsa Laplasi erdhi shumë kohë pas tyre. Të mos harrojmë se, megjithëqë përparimi i shkencës e tronditi nga themeli këtë pikëpamje të vjetruar mbi natyrën, ajo vazhdoi të sundonte* gjatë gjithë gjysmës së parë të shekullit XIX dhe në thelb ajo mësohet edhe sot në të gjitha shkollat**.

---

* Shënim anës dorëshkrimit: «Karakteri i ngurtë i pikëpamjes së vjetër mbi natyrën krijoi terrenin për t'i parë të gjitha shkencat e natyrës në mënyrë përgjithësuese dhe përmbledhëse si një të tërë: enciklopedistët francezë, në mënyrë ende thjesht mekanike — njërën pranë tjetrës; pastaj në të njëjtën kohë Sen-Simoni dhe filozofia gjermane e natyrës, e plotësuar nga Hegeli». *Red.*

** Se sa i patundur mundi të qëndronte në këto pikëpamje edhe më 1861 një njeri, veprat shkencore të të cilit kanë dhënë një material aq të vlefshëm për kapërcimin e tyre, e tregojnë këto fjalë klasike:

«Gjithë mekanizmi i sistemit tonë diellor, me sa jemi në gjendje ne ta kuptojmë atë, synon të ruajë atë që është, ta mbajë atë sa më gjatë në mënyrë të pandryshueshme. Ashtu si asnjë kafshë, asnjë bimë në botë që nga kohët më të lashta nuk është bërë më e përsosur ose në përgjithësi nuk është bërë tjetër, ashtu si në të gjithë organizmat ne gjejmë një vijueshmëri shkallësh që vijnë vetëm njëra *pranë* tjetrës, dhe jo njëra

Të çarën e parë në këtë pikëpamje të ngurtë mbi natyrën e hapi jo një natyralist, por një filozof. Në vitin 1755 doli «Historia e përgjithshme e natyrës dhe teoria e qiellit» e *Kantit*. Për shtytjen e parë nuk u bë fjalë më; Toka dhe gjithë sistemi diellor u paraqitën si diçka *që është formuar* në kohë. Sikur shumica dërrmuese e natyralistëve të mos kishte për mendimin atë neveri, të cilën Njutoni e shprehu me paralajmërimin: fizikë, ruaju nga metafizika! — ata edhe vetëm nga ky zbulim gjenial i Kantit duhej të kishin nxjerrë konkluzione që do t'i kishin shpëtuar nga endje të pafund nëpër rrugë të tërthorta dhe do t'u kishin kursyer një sasi shumë të madhe kohe dhe pune të harxhuar në drejtime të gabuara, sepse zbulimi i Kantit ishte pikënisja e gjithë përparimit të mëtejshëm. Në qoftë se Toka është diçka që është formuar, atëherë diçka e formuar duhet të jenë edhe gjendja e saj e sotme gjeologjike, gjeografike, klimaterike, bimët dhe kafshët e saj, dhe ajo duhet të ketë pasur një histori jo vetëm në hapësirë, — në formën e vendosjes së njërës pranë tjetrës, por edhe në kohë — në formën e vijueshmërisë së njërës pas tjetrës. Sikur studimi të ishte vazhduar menjëherë dhe me vendosmëri në këtë drejtim, shkencat e natyrës do të kishin ecur tani shumë më përpara se sot. Po ç'gjë të mirë mund të jepte filozofia? Vepra e Kantit mbeti pa ndonjë rezultat të drejtpërdrejtë derisa, pas shumë vjetësh, Laplasi dhe Hersheli e zhvilluan përmbajtjen e saj dhe e argumentuan më me hollësi, duke përgatitur

---

pas tjetrës, ashtu si vetë gjinia jonë nga pikëpamja trupore ka mbetur gjithnjë po ajo, — po ashtu edhe shumëllojshmëria e madhe e trupave qiellorë që ekzistojnë njëkohësisht nuk na jep të drejtë të supozojmë se këto forma janë vetëm shkallë të ndryshme të zhvillimit; përkundrazi, gjithçka që është krijuar është *njëlloj* e përsosur në vetvete» (*Medler*, Astronomia populore. Berlin, 1861, bot. i 5-të, f. 316).

kështu dalngadalë pranimin e «hipotezës nebulare».[97] Zbulimet e mëvonshme i sollën më në fund fitoren; më të rëndësishmet prej tyre ishin: konstatimi se yjtë e palëvizshëm kanë një lëvizje të vetën, prova e ekzistencës në hapësirën kozmike të një ambienti që ushtron rezistencë, konstatimi me anën e analizës spektrale i identitetit kimik të materies kozmike dhe i ekzistencës së masave nebulare inkandeshente, siç mendonte Kanti*.

Por mund të dyshohet se shumica e natyralistëve nuk do ta kishte kuptuar shpejt kontradiktën midis idesë se Toka ndryshon dhe teorisë se organizmat që jetojnë në të janë të pandryshueshëm, sikur pikëpamjes që sapo kishte lindur e që thoshte se natyra jo vetëm *ekziston*, por edhe ndodhet në një proces *formimi* dhe *zhdukjeje* të mos i kishte ardhur ndihmë nga një anë tjetër. Lindi gjeologjia dhe zbuloi jo vetëm ekzistencën e shtresave gjeologjike, të formuara njëra pas tjetrës dhe të vendosura njëra mbi tjetrën, por edhe guaskat dhe skeletet e kafshëve të zhdukura, trungjet, gjethet dhe frutat e bimëve që nuk ekzistojnë më, të ruajtura në këto shtresa. Duhej marrë guximi të pranohej se jo vetëm Toka në përgjithësi, por edhe sipërfaqja e saj e sotme dhe bimët e kafshët që jetojnë në të kanë një histori në kohë. Në fillim kjo nuk pranohej me qejf. Teoria e Kyvjesë mbi revolucionet që pëson Toka ishte revolucionare me fjalë dhe reaksionare në thelb. Aktin e vetëm të krijimit hyjnor ajo e zëvendësonte me një varg të tërë aktesh të përsëritura krijimi dhe e bënte mrekullinë levë esenciale të natyrës. Vetëm Lajeli futi arsyen e shëndoshë në gjeologji, duke zëvendësuar revolucionet e befasishme, të shkaktuara nga tekat e kri-

* Shënim anës dorëshkrimit: «Vetëm tani është kuptuar zbulimi i bërë po nga Kanti se baticat ushtrojnë një ndikim frenues mbi rrotullimin e Tokës. *Red.*

juesit, me veprimin gradual të transformimit të ngadalshëm të Tokës*.

Teoria e Lajelit, më shumë se të gjitha teoritë e mëparshme, nuk pajtohej me idenë se llojet organike janë të pandryshueshme. Ideja e transformimit gradual të sipërfaqes së Tokës dhe të të gjitha kushteve të jetës mbi të çonte drejtpërsëdrejti në teorinë e transformimit gradual të organizmave dhe të përshtatjes së tyre ndaj ambientit që ndryshon, çonte në teorinë e ndryshueshmërisë së llojeve. Mirëpo tradita është një forcë e madhe jo vetëm në kishën katolike, por edhe në shkencat e natyrës. Vetë Lajeli gjatë shumë vjetëve nuk e vuri re këtë kontradiktë, dhe nxënësit e tij ca më pak. Kjo mund të shpjegohet vetëm me ndarjen e punës që sundonte asokohe në shkencat e natyrës, për shkak të së cilës çdo shkencëtar kufizohej pak a shumë në fushën e vet speciale të diturisë dhe vetëm disa e ruajtën aftësinë për t'i parë gjërat në tërësinë e tyre.

Ndërkaq fizika bëri një hap shumë të madh përpara, rezultatet e të cilit u përmblodhën pothuajse njëkohësisht nga tre njerëz të ndryshëm më 1842, vit që bëri epokë në këtë degë të shkencave të natyrës[80]. Majeri në Hajlbron dhe Xhoulli në Mançester provuan shndërrimin e nxehtësisë në forcë mekanike dhe të forcës mekanike në nxehtësi. Gjetja e ekuivalentit mekanik të nxehtësisë u dha fund të gjitha dyshimeve në këtë drejtim. Po në atë kohë Grovi — natyralist jo profesionist, por avokat anglez — provoi me anë të një përpunimi të thjeshtë të disa rezultateve që ishin arri-

* E meta e pikëpamjes së Lajelit — të paktën në formën e saj fillestare — ka qenë se forcat që veprojnë në Tokë ai i quante konstante, konstante si nga cilësia, ashtu edhe nga sasia. Për të nuk ekziston ftohja e Tokës, Toka nuk zhvillohet në një drejtim të caktuar, ajo ndryshon vetëm rastësisht dhe pa lidhje të brendshme.

tur me kohë në fizikë se të gjitha të ashtuquajturat forca fizike — forca mekanike, nxehtësia, drita, elektriciteti, magnetizmi dhe bile e ashtuquajtura forcë kimike — kalojnë, në disa kushte, njëra në tjetrën, pa asnjë humbje force, duke provuar kështu edhe një herë, me anën e kërkimeve fizike, tezën e Dekartit se sasia e lëvizjes që ekziston në botë është e pandryshueshme. Në këtë mënyrë forcat e ndryshme fizike — këto, si të thuash, «lloje» të pandryshueshme të fizikës — u shndërruan në forma të lëvizjes së materies, të diferencuara në mënyrë të ndryshme dhe që kalojnë njëra në tjetrën sipas ligjesh të caktuara. Nga shkenca u hoq rastësia e ekzistencës së kësaj apo asaj sasie forcash fizike, sepse u provua lidhja e tyre reciproke dhe kalimi i tyre njëra në tjetrën. Fizika, ashtu si më parë astronomia, arriti në një rezultat të tillë, i cili dëshmonte në mënyrë të padiskutueshme se konkluzioni mbi ciklin e përjetshëm të materies që lëviz ishte konkluzioni i fundit i shkencës.

Zhvillimi çuditërisht i shpejtë i kimisë që nga koha e Lavuazjesë, e sidomos që nga koha e Daltonit, i përmbysi pikëpamjet e vjetra mbi natyrën edhe nga një anë tjetër. Duke përftuar me rrugë inorganike komponime të tilla kimike, të cilat deri në atë kohë lindnin vetëm në organizmin e gjallë, u provua se ligjet e kimisë kanë fuqi si për trupat organikë, ashtu edhe për trupat inorganikë, dhe u mbush një pjesë mjaft e madhe e atij hendeku, gjoja përgjithmonë të pakapërcyeshëm, që ndante natyrën inorganike nga ajo organike, ekzistencën e të cilit e pranonte edhe Kanti.

Më në fund, edhe në fushën e kërkimeve biologjike udhëtimet dhe ekspeditat shkencore, të organizuara në mënyrë sistematike që nga mesi i shekullit të kaluar, studimi më i saktë i kolonive evropiane në të gjitha kontinentet nga specialistët që jetonin atje, pastaj edhe sukseset e paleontologjisë, të anatomisë dhe të fiziologjisë në përgjithësi, sidomos pas përdorimit sistematik

të mikroskopit dhe pas zbulimit të qelizës — të gjitha këto grumbulluan aq shumë material, saqë u bë i mundshëm, dhe njëkohësisht i domosdoshëm, zbatimi i metodës krahasuese*. Nga njëra anë, në saje të gjeografisë fizike krahasuese u përcaktuan kushtet e jetës së florave dhe të faunave të ndryshme dhe, nga ana tjetër, u krahasuan njëri me tjetrin organizmat e ndryshëm përsa u përket organeve të tyre homologe, dhe jo vetëm në gjendje pjekurie, por edhe në të gjitha shkallët e zhvillimit të tyre. Sa më i thellë dhe më i saktë ishte ky studim, aq më tepër dërrmohej sistemi i ngurtë i natyrës organike të pandryshueshme, që karakterizuam më lart. Jo vetëm që bëheshin gjithnjë më të papërcaktuar kufijtë midis llojeve të ndryshme të bimëve dhe të kafshëve, por edhe u gjetën kafshë, si amfioksi dhe lepidosireni[81], të cilat ishin një tallje me gjithë klasifikimin që kishte ekzistuar deri atëherë**; dhe, më në fund, u gjetën organizma, për të cilët as që mund të thuhej nëse bëjnë pjesë në botën shtazore apo në botën bimore. Boshllëqet e analeve paleontologjike mbusheshin gjithnjë më tepër, duke i detyruar edhe ata më kokëfortët të pranonin paralelizmin e habitshëm që ekziston midis historisë së zhvillimit të botës organike në tërësi dhe historisë së zhvillimit të një organizmi të veçantë, duke dhënë në këtë mënyrë fillin e Ariadnës që duhej t'i nxirrte nga labirinti, në të cilin, siç dukej, po ngatërroheshin gjithnjë më tepër botanika dhe zoologjia. Është karakteristike se pothuaj në një kohë me sulmin e Kantit kundër teorisë së përjetësisë së sistemit diellor K.F. Volfi ndërmori më 1759 sulmin e parë kundër teorisë së pandryshueshmërisë së llojeve, duke shpallur teorinë e evolucionit. Por ajo që te ai ishte vetëm një parashikim

* Shënim anës dorëshkrimit: «Embriologjia».

** Shënim anës dorëshkrimit: «Ceratodi. Po ashtu edhe arkeopteriksi etj.»[82].